

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Qarkut në Prizren me trupin gjykues përbërë nga gjykatësi ndërkombëtar Georg Plüür si kryetar i trupit gjykues dhe gjykatësi ndërkombëtar Raymond Levy dhe gjykatës Genc Nixha si anëtarë të trupit gjykues, me pjesmarrjen e procesmbajtëseve Zj. Eileen Byrne and Zj. Maria Elenie Velasquez, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit Sasa Grkovic, emri babait [REDACTED] dhe nënës [REDACTED] Millenkovic, lindur më 15 Qershor 1971 në Prizren, banor i përhershëm i Rahovecit, Rr.Ustanicka, 28, i nacionalitetit Serb, beqar, me profesion hotelier, i gjëndjes së mesme ekonomike, i padënuar më parë, në paraburgim që në 2 Qershor 2001, dhe i akuzuar me veprat penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile sipas Nenit 142 kombinuar me Nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("LPJ"), në bazë të aktakuzës së Prokurorit Publik Ndërkombëtar në Prizren. PP.Nr.132/2001 të datës 19 Shkurt 2002, dhe më vonë ndryshuar në gjykimin kryesor në 2 Shtator 2002, mbas mbajtjes së seancave publike të gjykimit në 29 dhe 31 Korrik dhe 2, 5, 7, 9, 12, 14, 16, 19, 22, dhe 23 Gusht dhe 2 e 4 Shtator 2002, të gjitha në prani të akuzuarit, avokatëve të tij mbrojtës, Miodrag Brkljac, Zivojin Jokanovic, Milorad Panjevic, dhe të Prokurorit Publik Ndërkombëtar, Christopher Maxwell, dhe të gjitha në Gjykatën e Qarkut në Prizren me perjashtim të séances së datës 21 Gusht 2002, që u mbajt në Gjykatën e Qarkut në Beograd, në seancën publike në prani të Prokurorit Publik Ndërkombëtar të Prishtinës Christopher Maxwell dhe të avokatit mbrojtës të akuzuarit, Miodrag Brkljac, dhe që është lexuar në proceverbalin e gjykimit kryesor të 22 Gusht 2002, në 04 Shtator 2002 shpall në publik si më poshte:

**AKTGJYKIM**

I akuzuari Sasa Grkovic, emri babait [REDACTED] dhe nënës [REDACTED] lindur më 15 Qershor 1971 në Prizren, banor i përhershëm i Rahovecit, Rr.Ustanicka, 28, i nacionalitetit Serb, beqar, me profesion hotelier, i gjëndjes së mesme ekonomike, i padënuar më parë, në paraburgim që më 2 Qershor 2001, akuzuar me veprën penale krime lufte kundër popullsisë civile sipas Nenit 142 kombinuar me Nenin 22 të LPJ, i zbatuar sipas Rregulloreve të UNMIK-ut 1999/24 dhe 2000/59

**GJËNDET I PAFAJSHËM**

Për shkak të mungesës së provave në përputhje me Nenin 350, Paragrafi 3 të LPP.

Kështu që, i akuzuari Sasa Grkovic,

**LIROHET**

nga ngarkimet e aktakuzës, PP No. 132-2001, të datës 19 Shkurt 2002, se ai gjatë konfliktit të armatosur në rajonin e Prizrenit gjatë Marsit 1999, dhe gjatë luftës në Kosovë nga 24 Marsi 1999 deri më 12 Qershor 1999 në territorin e rajonit të Prizrenit dhe në fshatrat e Mamushës, Krushës së Vogël, Celinës, Nogavacit, dhe Bella Cerkes ka shkelur ligjet ndërkombëtare për veprat që vijojnë:(1) në 27 Mars 1999, i akuzuari, ndërsa bënte pjesë në një grup të armatosur të

efektivit Serb prej gjashtëmbëdhjetë personash të uniformuar, qëllimisht vranë katër Shqiptarë të Kosovës: R [REDACTED] S [REDACTED] Sh [REDACTED] S [REDACTED], S [REDACTED] S [REDACTED] dhe M [REDACTED] S [REDACTED] në fshatin Mamushë; (2) në 25 Mars 1999, i akuzuari, Sasa Grkovic, ndërsa bënte pjesë në një grup të armatosur të efektivit Serb të uniformuar në afërsi të Bellacerkës mori pjesë në shkatërrimin pa shkak të shtëpive dhe pasurive, dëbimin me forcë të fshatarëve, dhe ai mori pjesë në masakrën e 33 – 38 civilëve të pa armatosur tek Ura e Bellajës si dhe të 13 civilëve të tjerë duke shtënë mbi ta me armë automatike, duke vranë ndër të tjerë N [REDACTED] P [REDACTED], A [REDACTED] P [REDACTED] dhe Sh [REDACTED] P [REDACTED] (3) në 26 Mars 1999, i akuzuari Sasa Grkovic bënte pjesë në një grup të armatosur të efektivit Serb të uniformuar që rrethoi dhe mori peng mbi 100 qytetarë Shqiptarë të Kosovës të pa armatosur në fshatin Krusha e Vogël dhe i rreshtuan ato mbas murit dhe shtinë mizorisht dhe pa dallim mbi to që shkaktoi një numër të konsiderueshëm të vdekurish; (4) në 28 Mars 1999, i akuzuari Sasa Grkovic, veshur me uniformë maskimi dhe me pushkë automatike, ishte në një grup të madh Serbësh të uniformuar që qëllimisht shkatërruan dokumentat identifikues dhe i grabiten nën grykën e armëve paratë dhe sendet e tjera të cmuara fshatarëve të Celinës dhe Nogovacit (5) në 26 Mars 1999 i akuzuari Sasa Grkovic, mori pjesë si anëtar i një grupi të armatosur Serbësh të uniformuar në masakrën e civilëve Shqiptarë të Kosovës në fshatin Celinë.

Paraburgimi përfundon në bazë të Nenit 353 Paragrafi 3 te LPP.

Ne bazë të Nenit 108, Paragrafi 3 të LPP, palët e dëmtuara udhëzohen se ato mund të ndjekin pretendimet e tyre pasurore nën një procedurë civile.

Në bazë të Nenit 99, Paragrafi 1 dhe në lidhje me Nenin 95, Paragrafi 2, Pika 1-5 të LPP, shpenzimet e procedurës penale, duke përfshirë dhe shpenzimet e nevojshme dhe shpërblimet e avokatëve mbrojtës, duhet të paguhet nga buxheti i Gjykatës.

## ARËSYETIM


### I. HYRJE

#### A. Aktakuza

Në 19 Shkurt 1999, Prokurori Publik Nderkombëtar në Prizren paraqiti një aktakuzë, PP. No. 132/2001, në të cilën e emëron Sasa Grkovic si të akuzuar. Aktakuza thoshte që Sasa Grkovic ka kryer veprat penale që përbëjnë krime të luftës kundër popullsisë civile sipas Nenit 142 të Ligjit Penal të Jugosllavisë (LPJ). Aktakuza është ndryshuar gjatë fjalës përfundimtare të Prokurorit Publik. Neni 142 i LPJ është ligji i zbatueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 “Mbi ligjin e zbatueshëm në Kosovë” dhe ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59. Sipas aktakuzës, veprat e kryera nga Sasa Grkovic kanë ndodhur në fshatra të ndryshëm të Rajonit të Prizrenit dhe përbëjnë krime lufte.

#### 1. Ngarkimet ndaj Grkovic

Aktakuza e ngarkon Grkovic me akuzën e vetme të krimeve të luftës në bazë të veprave të mëposhtme:



- Së pari, aktakuza – mbasi u ndryshua- supozon se në 25 Mars 1999, në fshatin Bellacerkë, Grkovic mori pjesë në shkatërrimin e shtëpive dhe pasurive, dëbimin e fshatarëve dhe masakrën e tridhjetë e tre deri në tridhjetë e tetë civilëve, si dhe të trembëdhjetë të tjerëve, duke shtënë mbi ta me armë automatike.
- Së dyti, aktakuza supozon se në 26 Mars 1999, në fshatin Krushë e Vogël, Grkovic ishte anëtar i një grupi të armatosur Serbësh të uniformuar që rrethuan mbi njëqind civilë dhe shtinë mbi ta pa dallim, duke shkaktuar një numër të konsiderueshëm të vvarësh.
- Së treti, aktakuza, mbasi është ndryshuar, supozon se në 28 Mars 1999, në fshatin Celinë dhe Nogavac, Grkovic ishte midis një grupi të uniformuar të efektivit Serb që shkatërruan dokumentat e identitetit dhe që nën grykën e armëve grabitën para dhe sende të tjera të cmuara të fshatarëve nga Celina dhe Nogavacit.
- Së katërti, aktakuza supozon se në 27 Mars 1999, në fshatin Mamushe, Grkovic ndërsa ishte në një grup të armatosur të 16 personave të efektivit Serb, më qëllim vrau katër civilë.
- Së fundi, aktakuza, mbasi është ndryshuar, supozon se në 26 Mars 1999, në fshatin Celinë, Grkovic, si anëtar i nje grupi të uniformuar të efektivit Serb, mori pjesë në masakrën e civileve.

## 2. Paraburgimi i Grkovicit

Në vijim të urdhërit të Gjykatësit Hetues vendor, Sasa Grkovic u arrestua në 2 Qershor 2001 dhe është mbajtur në paraburgim që nga dita e arrestit të tij deri më tash.

### B. Kompetenca e Gjykatës

#### 1. Kompetenca e Gjykatës së Qarkut në Prizren

Gjykata e Qarkut në Prizren është organi kompetent juridik për të zhvilluar këtë procedurë penale.

Sipas Ligjit Jugosllav të Procedurës Penale, Neni 22, çështja e juridiksionit për çështjet penale është përcaktuar nga Ligji i Republikës apo Provincës Autonome përkatëse. Ligji i Kosovës mbi Gjykatat e Rregullta ("LGJR"), Neni 29, thotë se Gjykatat e Qarkut janë kompetente për të zhvilluar çështje penale që kanë të bëjnë me ngarkime për të cilat ligji parashikon dënime penale me burgim për pesë vjet apo më tepër. Në bazë të Nenit 26 (1) të LPP, juridiksioni territorial i takon Gjykatës në rajonin e të cilës thuhet se janë kryer krimet.

Sic gjehet më lart, akuzat për krime lufte kundër popullsisë civile sipas Nenit 142 të LPJ parashikojnë një dënim për një minimum prej pesë vjetësh burgim. Për më tej, aktakuza në këtë rast thotë se i akuzuari ka kryer krime lufte në fshatrat e Bellacerkës, Mamushës, Krushës së Vogël, Celinës dhe Nogavacit, që ndodhen të gjitha në Rajonin e Prizrenit.

## 2. Përbërja e Trupit Gjykues

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/64, "Mbi caktimin e Gjykatësve/Prokurorëve Ndërkombëtare dhe/ose ndryshimin e vendit", Përfaqsesi Posacëm i Sekretarit të Përgjithshëm ("PPSP) mund të urdhërojë caktimin e Gjykatësve Ndërkombëtarë dhe/ose të një Prokurori Ndërkombëtar për një procedurë penale. Në 26 Korrik 2002, Departamenti i Drejtësisë, duke vepruar në bazë të vendimit të Përfaqsesit të Posacëm të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/64, emëroi Gjykatësin Georg Plüür, gjykatës ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut në Prizren, si kryetar të trupit gjykues për këtë çështje dhe gjykatësin Raymond Levy, gjykatës ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut në Gjilanë, si anëtar i trupit gjykues. Gjykatësi i tretë i trupit gjykues, gjykatësi Genç Nixha, u emerua në 15 Korrik 2002 nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prizren.

Asnjë nga palet nuk e kundërshtuan përbërjen e trupit gjykues.

### C. Gjykimi kryesor

Gjykimi ishte i hapur për publikun. Me kërkesë të avokateve mbrojtës, një séance u mbajt në 21 Gusht 2002 në Gjykatën e Qarkut në Beograd. Avokati mbrojtës kerkoj një séancë në Beograd për të dëgjuar dëshmitë e disa dëshmitarëve që nuk jetonin më në Kosove dhe që refuzuan të dëshmonin në Prizren. Gjykata dinte se i akuzuari do të vuante pasojat e paragjyqimit në se ai nuk do të kishte mundësi të paraqisë dëshmitarët që të jepnin dëshmitë në lidhje me të. Për këtë arsye, Gjykata vendosi të dëgjojë në Beograd dëshmitë e dëshmitarëve të propozuar, duke mënjanuar në këtë mënyrë ndonjë problem të masave të sigurisë që mund të kishin penguar dëshmitarët për dhënien e dëshmisë.

Në bazë të Nenit 7 dhe 8 të LPP, përkthyesit ndërkombëtare përkthyen procedurën gjyqësore dhe të gjithë dokumentat e Gjykatës që kishin lidhje me gjykimin, në gjuhët Serbisht dhe Shqip sipas nevojës.

## II. LIGJI I APLIKUESHËM

Aktakuza e ngarkoi të akuzuarin me veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullsisë Civile sipas Nenit 142 të LPJ. Ky Nen ndalon urdhërimin apo kryerjen e akteve të ndryshme kundër popullsisë civile gjatë luftës apo konfliktit të armatosur, në se urdhërimi apo egzekutimi i këtyre urdhërave shkel ligjet ndërkombëtare. Neni 142 i LPJ i referohet një serie veprimesh të dënueshme, që përfshin vrasjet, shkeljen e paprekshmërisë trupore, përzënien dhe shpërnguljen, aplikimin e masave të frikësimit dhe terrorit, punës së detyruar, konfiskimin e pasurisë; dhe plackitjen.

## III. VLERËSIMI I AKUZËS KUNDËR GRKOVIC

Sipas Nenit 142 të LPJ, me qëllim që gjehet Sasa Grkovic fajtor për krime lufte kundër popullsisë civile, duhej të provoheshin këto elementë: 1) egzistenca e luftës, e konfliktit të armatosur apo pushtimi; 2) viktimat e veprave të dënueshme nga ligji të jenë civilë; 3) i akuzuari urdhëroi kryerjen, apo kreu, aktin apo veprat e përmendura; dhe 4) kryerja e veprës apo veprave të pretenduara janë të dënueshme në bazë të Nenit 142 të LPJ dhe janë në kundërshtim me ligjet ndërkombëtare në fuqi në kohë e lufte apo konflikti të armatosur.

Pervec urdhërimit dhe kryerjes së veprave të pretenduara më lart, i akuzuari mund të gjendet fajtor për krime lufte kundër popullsisë civile në se ai ka marrë pjesë në aktet kriminale ose në ndonjë mënyrë ishte përfshirë si bashkëfajtor në apo kryerjen e veprave, sipas Nenit 22 të LPJ. Kjo shkurtimisht tregon që elementi e parë, i dytë dhe i katërt janë të padiskutueshëm.

## **A. Egzistenca e konfliktit të armatosur**

Krimet e luftës kundër popullsisë civile mund të kryhen vetëm gjatë luftës, konfliktit të armatosur apo pushtimit. Ndërsa lufta është e përcaktuar sipas komentareve standarte, si konflikt i armatosur midis shteteve, konflikti i armatosur përfshin një konflikt të armatosur midis forcave politike, kombësive apo forcave të tjera brenda kornizës së të njëjtit shtet.

Është e padiskutueshme se në Kosovë, dhe në rajonin e Prizrenit egzistonte një konflikt i brendshëm i armatosur midis forcave Serbe (që përfshinte Ushtrinë e RFJ, njësite policore Serbe dhe grupet Serbe të paramilitareve) dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UCK") gjatë periudhës së kohës në shqyrtim, Mars 1999. Natyrisht, avokatët mbrojtës nuk e kundërshtuan kurrë çështjen e konfliktit të armatosur. Për këtë arsye, konflikti i armatosur egzistonte sic parashikohet në Nenin 142 të LPJ gjatë të gjithë kohës që ka lidhje me këtë çështje.

## **B. Viktimat e veprave në shqyrtim janë civilë**

Gjykata gjen se nuk ka diskutim se viktimat e veprave që lidhen me këtë çështje penale ishin civilë. Popullsia civile, në fakt, nuk është përcaktuar në Nenin 142 të LPJ, por është përcaktuar në Konventën e IV të Gjenevës dhe në Protokollin Shtesë të Konventës së Gjenevës të 12 Gushtit 1949, dhe Në lidhje me Mbrojtien e Viktimave të Konfliktëve të Armatosur Jo-Nderkombetare (1977) ("Protokolle"). Këto instrumente janë të referuara nga Neni 142 i LPJ sipas ligjeve ndërkombëtare, në të cilat RFJ është pjesëtare. Konventa e IV e Gjenevës përcakton një civil si dikë që nuk merr pjesë aktive në veprime ushtarake. Komentari i Protokollit qartëson se civilët janë ato që nuk janë anëtarë të forcave të armatosura apo luftëtarëve të tjerë të ligjshëm.

Viktimat e këtyre mizorive nuk kane marrë pjesë në ndonjë veprim ushtarak dhe ato nuk mund të karakterizohen ndryshe, por vetëm si civile, edhe në se anëtarët e UCK ishin në, apo përreth fshatrave në kohën e krimit të luftës në fjalë. Në të vërtetë, mbrojtia nuk e kundërshtoi kurrë këtë. Për këtë arsye, Gjykata e gjen të padiskutueshme që viktimat e veprave të thëna ishin civilë.

## **C. Urdhërimi, Kryerja ose Pjesëmarrja në veprat e dënueshme.**

Aktakuza e ngarkon Grkovicin me krime lufte në bazë të disa akteve, që paraqiten më poshte më në hollësi. Në cdo ngarkim kundër Grkovic thuhet se, ose ka kryer krimet e luftës ose se ai ishte anëtar i forcave Serbe që kryen krimet e luftës. Ky është elementi që është kundërshtuar në këtë çështje penale.

Sipas komentarit rreth Nenit 142 të LPJ, mënyra e kryerjes së krimit të luftës përfshin ato persona të cilët urdhërojnë aktivitetet e paligjëshme, si dhe ato që zbatojnë urdhërat. Megjithatë, personat mund të gjenden fajtorë për krime lufte kundër popullsisë civile për shkak të pjesëmarrjes, sipas Nenit 22 të LPJ, që parashikon se "në se disa persona marrin pjesë në një akt kriminal ose në ndonjë mënyrë përfshihen si bashkëpunëtorë, secili prej tyre do të dënohet sipas dënimit të përshkruar". Vec kësaj, Neni 142 kërkon që ato që urdhërojnë apo kryejnë aktivitetet e paligjëshme të jenë anëtarë të organizatave ushtarake, politike apo administrative që marrin pjesë në konflikt.

Pra, analizimi i këtij elementi i kërkon Gjykatës të përcaktojë së pari në se i akuzuari Sasa Grkovic, ka kryer apo ishte bashkëpunëtor për cka akuzohet. Është e padiskutueshme se i akuzuari ishte anëtar i mbrojties territoriale që nga 25 Marsi 1999. Më konkretisht, çështja nuk

është në se aktivitetet e paligjëshme të përmendura kanë ndodhur në të vërtetë, por në se i akuzuari vetë ka kryer apo ishte bashkëpunëtor në krimet e përmendura të luftës. Gjykata i kushtoi vëmendje serioze përfshirjes së Grkovicit, pa dyshim e vetëdijshme se testi i "vërtetimit pa asnjë dyshim të arsyeshëm" përfshin konsiderime në se provat nxjerrin në pah jo vetëm fajësinë por gjithashtu mundësitë e drejta dhe të arsyeshme të pafajësisë. Testi nuk kërkon përjashtimin e çdo hipoteze apo mundësie të pafajësisë.

Sic paraqitet më poshtë, kjo Gjykatë ka marrë në konsideratë të gjithë provat e pranueshme të paraqitura nga palët, që përfshijnë dëshminë e të akuzuarit, dëshmitë e dëshmitarëve pamorë (duke përfshirë një vlerësim të procedurës hetimore për sa i përket ndikimit të saj në seriozitetin e identifikimeve të mëtejme të dëshmitarëve pamorë), dëshmitarëve të alibisë, dhe provat dokumentare të pranueshme, inspektimin e vendit të ngjarjes, dhe argumentet e Prokurorit Publik Ndërkombëtar dhe të avokatëve mbrojtës. Në bazë të gjithë provave të paraqitura, kjo Gjykatë arrin në përfundimin se nuk e gjen fajtor të akuzuarin për krime lufte kundër popullsisë civile përtej dyshimit të arsyeshëm.

## **1. Procedura e identifikimit nga dëshmitarët pamorë**

Përpara vlerësimit të provave të paraqitura për secilin ngarkim që përmban aktakuza, duhet së pari të konsiderohen saktësia dhe paanshmëria e të gjithë procedurës së identifikimit të dëshmitarëve pamorë, që është një faktor vendimtar në vlerësimin e besueshmërisë së dëshmisë së dëshmitarëve pamorë. Sic diskutohet më hollësisht më poshtë, kjo Gjykatë gjen se procesi i identifikimit kishte mangësi dhe vetë procedura përmbante të meta serioze, duke vënë në pikëpyetje edhe besueshmërinë e identifikimeve të para. Për më tepër, edhe identifikimet e mëpasme u panë të jenë qenësish të pa besueshme deri në atë pikë që nuk mund të jenë identifikime të pavarura. Për këtë arsye, Gjykata nuk mund ti japë ndonjë rëndësi të madhe provave të identifikimit.

Kjo Gjykatë duhet ta bëjë të qartë që në fillim se ndërsa raportet e KFOR-it dhe të Policisë së UNMIK-ut nuk janë të pranueshme si prova në atë gjëndje sic janë në shkresat e lëndës së Gjykatës, vetë dëshmitë e nxjerra gjatë procedurës nga përdorimi i këtyre raporteve për qëllime ballafaqimi përbëjnë provë të pranueshme. Vec kësaj, me qëllim që të vlerësohet besueshmëria e identifikimeve të mëpasme nga dëshmitarët pamorë, është e rëndësishme për këtë Gjykatë të vlerësojë paraprakisht procedurat e identifikimit fillestar të zbatuara nga KFOR-i dhe Policia e UNMIK-ut.

Sic konfirmojnë dëshmitë e dëshmitarëve pamorë, dëshmitë fillestare të dëshmitarëve pamorë janë marrë nga KFOR-i në 1999, mbas luftës. Më vonë, Policia e UNMIK-ut mori dëshmi të tjera në vitin 2000 dhe në fund Gjykatësi Hetues ndërmoi hetimet e tij, duke përfshirë edhe rreshtimin e personave në Gusht 2001.

### **a. Procedurat e KFOR-it dhe të Policisë së UNMIK-ut për identifikimin nëpërmjet fotografive**

Nga një shikim i dosjes së lëndës së Gjykatës del që hetuesit e KFOR-it kanë vizituar mbas luftës disa herë dëshmitarët e mundshëm, për të marrë dëshmitë e tyre dhe duke i treguar atyre fotografitë të gjenin në se dëshmitarët mund të identifikonin ndonjë nga kryerësit e krimeve apo anëtare të forcave të përfshirë në krime lufte.

Problemin më të rëndë që vëren Gjykata, për sa i përket këtyre dëshmimeve është mungesa serioze e hollësirave dhe saktësisë së raporteve të KFOR-it. Shumica e raporteve janë sipërfaqësore dhe në shumë raste jo-egzistentë. Shumë nga dëshmitarët dëshmojnë të jenë vizituar shumë herë nga hetuesit e KFOR-it për të parë fotot, dhe në shumicën e rasteve gjëndet vetëm

një raport në dosjen e lëndës së Gjykatës. Pa raportet e vizitave të tjera, kjo Gjykatë mundet vetëm të marrë me mend se çfarë i është thënë dëshmitarëve, në se i është dhënë ndonjë udhëzim dëshmitarëve, në se dëshmitarëve i është thënë se këto fotografi mund të mos përmbajnë foto të dyshimtëve, se sa fotografi janë paraqitur dhe të kujt të dyshimti, në se fotografitë janë treguar në mënyrë sugjестive. Këto janë vetëm disa nga faktorët që duhen të konsiderohen në vlerësimin e saktësisë dhe panashmërisë në rreshtimin e fotografive. Ndërkohë raporteve të gjëndura në dosjen e lëndës, i mungonin hollësisir, dhe sic doli, shumë nga hollesirat u hodhën poshtë nga dëshmitarët gjatë gjykimin, duke vënë në pikëpyetje saktësinë e informacioneve të raporteve. Në mënyrë të vecantë, asnjë nga raportet e KFOR-it nuk ka dokumentuar se çfarë fotografish i janë treguar dëshmitarëve dhe/ose të bashkëngjisnin fotografitë e të dyshuarve të identifikuar.

Problemi i dytë që ka të bëjë me identifikimet e fotografive është fakti i thjeshtë se në shumë raste, dëshmitarëve i janë treguar fotografitë disa herë, në vënd që ti tregoheshin një herë të vetme. Ndërlíkimi në një proces të tillë është se hetuesit i riktheheshin dëshmitarëve deri sa dëshmitarët të identifikonin ato të dyshimtë që hetonte KFOR-i. Dëshmitë pasuese të dëshmitarëve e vërtëtojnë këtë problem. Për shëmbull Z. [REDACTED] S. [REDACTED] deklaroi: “Policët më treguan mua fotografitë dhe unë kisha përshtypjen se e kisha identifikuar të dyshimtin”. Në se dëshmitari ka identifikuar dikë që ai/ajo beson se ishte i dyshimti, ai/ajo do të vazhdojë të përpiqet të identifikojë atë person, duke minuar në këtë mënyrë besueshmërinë e cdo rreshtimi pasues duke përfshirë dhe rreshtimin e personave. Ky problem është faktuar nga dëshmia e N. [REDACTED] R. [REDACTED] që pohoi se “policia më tregoi shumë fotografi dhe unë identifikova njërin prej tyre si të dyshimtin. Sot unë kam ndër mënd të identifikoj të njëjtin person”.

Mungesa e një procedure të drejtë dhe të saktë të identifikimit nga KFOR-i, është vënë re edhe nga një oficer i Policisë së UNMIK-ut që ka punuar për hetimet. Z. John Eisler deklaroi se mbasi shqyrtoi intervistat e kryera nga KFOR-i, ai kishte dyshime serioze për cilësinë e punës. Z. Eisler deklaroi se, për shëmbull, nuk kishte vazhdimësi në hetuesit që merreshin me dëshmitarët. Përvec kësaj, ai vuri në dukje, se një hetues mundet që me apo pa qëllim të injektojë një përgjigje të dëshiruar duke bërë pyetje sugjестive dhe ai arriti në përfundimin se së paku në një rast, në një intervistë me Z. Zh. [REDACTED] ka ndodhur pikërisht kështu.

Hetimet e mëtejshme policore vuajtën nga te njejtat pamjaftueshmëri si me hetimet e bëra nga hetuesit KFOR-it të përmëndura më lart. Përvec kësaj, kjo Gjykatë do të vejë në dukje se këto hetime të tjera të policisë vetëm se e përzien më tej çështjen e seriozitetit përse i përket rreshtimit të fotografive që diskutuam më lart.

Sipas kësaj, kjo Gjykatë jo vetëm që e gjen të vështirë të mbështetet në saktësinë e raportimit, por ka dyshime serioze në lidhje me besueshmërinë e identifikimeve të bëra gjatë procesit dhe rreth identifikimeve vijuese të bëra nga dëshmitarët për shkak të natyrës së qenësishme sugjестive që i krijohet dëshmitarëve nga shikimi i disa rreshtimeve të fotografive pa patur kontrollin e duhur.

#### **b. Hetimet e Gjykatës – Rreshtimi për identifikim i personave**

Mbasi i akuzuari është arrestuar dhe paraburgosur, është organizuar një rreshtim për identifikim në Kampin Phoenix në 20 Gusht 2001, si pjesë e hetimeve të Gjykatës. Përvec të akuzuarit në këtë rreshtim për identifikim u përzgjedhën edhe gjashtë ushtarë Gjermanë. Të gjithë personat e zgjedhur kishin flokë në ngjyrë të errët, sipas dokumentacionit ato ishin rreth 185 – 195 cm, të hollë dhe ishin në moshat midis 25 dhe 35 vjec. Ato ishin të veshur të gjithë njësoj dhe ato kanë ndërruar numrat për cdo herë që janë parë nga një nga dëshmitarët. Pavarësisht këtyre masave, Gjykata gjen nuk janë ndërmarrë disa masa të tjera shtesë që të sigurohej një identifikim i drejtë dhe serioz.

Së pari, nuk ka asnjë provë që të tregojë se çfarë udhëzimesh i janë dhënë dëshmitarëve në se i janë dhënë të tilla. Ndërmjet të tjerave, është e rëndësishme të udhëzohen dëshmitarët se i dyshimti mund të mos jetë midis atyre që marrin pjesë në rreshtim. Duke vepruar në këtë mënyrë, mënjanohet ajo që ka mundësi të ndodhë që dëshmitarët thjesht të zgjedhin personin që ato mendojnë që ka mundësi të jetë i dyshimti. Është po kaq e rëndësishme të sigurohet, që dëshmitarët të japin një përshkrim të hollësishëm të personit që ato dëshmojnë se ka kryer krimin, përpara se të bëjnë ndonjë identifikim. Kjo mënyrë, ndihmon në atë që dëshmitari të mos zgjedhë thjesht personin që ngjan më tepër me fajtorin. Për më tepër, për të përcaktuar sigurinë dhe seriozitetin e identifikimit të dëshmitarëve nuk tregohet që është bërë ndonjë gjë tjetër përveçse të pyeturës sipërfaqore të dëshmitarëve.

Së dyti, sic preket më lart, deri në kohën që u bë rreshtimi i personave për identifikim, dëshmitarët kishin kaluar nëpër disa seanca pyetjesh dhe identifikuan të dyshimtë të ndryshëm. Ky fakt i vetëm e zvogëlon besueshmërinë e një identifikimi në këtë fazë të gjykimit.

Përveç kësaj, megjithëse personat e zgjedhur për të marrë pjesë në rreshtim ishin përshkruar se kishin flokë të errët, 185-195 cm të gjatë, të hollë, dhe në moshë midis 25 dhe 35 vjeç, ato nuk i ngjanin të akuzuarit. Një dëshmitare monitoroi rreshtimin e personave si Monitoruese e Sistemeve Ligjore nga Organizata për Siguri dhe Bashkepunim në Europë. Zj. Carmela Buehler dëshmoi në gjyq së megjithëse ajo nuk ishte informuar se kush ishte i akuzuari, ajo ishte në gjëndje ta identifikonte lehtësisht atë nga personat e rreshtuar. Sipas Zj. Buehler, i akuzuari ishte i vetmi person në rreshtim me pamje të një Sllavi dhe dukej më i hollë dhe më i zbehtë se të tjerët. Shikimi i fotografive të personave të rreshtuar për identifikim, që vlen të theksohet se mungonin nga dosja e lëndës deri pak përpara gjykimit, mbështet plotësisht përfundimin e Zj. Buehler.

Shkurtimisht, kjo Gjykatë gjen se akumulimi nga tregimet e fotografive, pasuar nga një rreshtim i personave, con në një proces jo serioz të njohjes së personave të rreshtuar për identifikim. Duke e marrë së bashku me faktin se Gjykata ndeshet me mungesën në procesverbal të udhëzimeve të dhëna nga Gjykatësi Hetues, me pyetjet sipërfaqore të dëshmitarëve për sa i përket identifikimit të tyre, dhe sugjestiviteti nga përfshirja e vetëm ushtarëve Gjermanë në rreshtimin për identifikim, bën që kjo Gjykatë të përcaktojë se rreshtimi i personave është qenësisht sugjestiv, dhe si i tillë zbeh përcaktimin në se i akuzuari mori pjesë në kryerjen e krimeve të luftes sic akuzohet. Duke patur parasysh këtë, Gjykata verifikoi provat e paraqitura për sa i përket secilit nga pesë ngarkimet kundër të akuzuarit për krime lufte kundër popullsisë civile.

## 2. Dëshmia e Grkovic

Në gjykim, Sasa Grkovic, mohoi të gjithë ngarkimet kundër tij duke deklaruar se ai nuk ka të bëjë fare me ato. I akuzuari spjegoi se ai ishte mobilizuar në 25 Mars 1999 deri në 12 Qershor 1999, gjë që u provua nga librezat e tij ushtarake. Sipas fletëthirrjes, ai u paraqit tek rezervuari në pjesën e sipërme të Rahovecit në datë 25 Mars 1999, si pjesëtar i Forcave të Mbrojtjes Territoriale. Atij i ishte dhënë më parë një armë dhe një uniformë. Uniforma ishte njëngjyrëshe ulliri SMB. Grkovic dëshmoi se ai ishte caktuar në ndërtesën 4 Korriku në pjesën e sipërme të Rahovecit si roje siguri dhe se ai kishte qëndruar atje për 10 ditët e para të konfliktit. Ai dëshmoi se ai kaloi të gjithë kohën nga 24 Marsi deri në 28 Mars 1999 tek ndërtesa 4 Korriku dhe kafeteria e tij, që ndodhej 40 metra larg. Grkovic, në mënyrë të pabesueshme dëshmoi në gjyq se deri para paraburgosjes së tij, ai as nuk dinte për ndonjë masakër që kishte ndodhur në fshatrat përreth gjatë kohës së luftës që kishte të bënte me ngarkimet kundër tij.

I akuzuari dëshmoi gjithashtu se janë katër Sasa Grkovic të tjerë që jetojnë në atë zonë, me të cilët mundet ta kenë ngatërruar. Një Sasa Grkovic tjetër është gjithashtu anëtar i Mbrojtjes



Territoriale dhe babai i tij quhet P [REDACTED]. Ky Sasa Grkovic është një vit më i ri se i akuzuari dhe ai mendon se ky Sasa i përngjan atij nga ana e fizikut. Ai dëshmoi gjithashtu se është një Sasa Grkovic, emri i babait të tij është B [REDACTED] dhe ai ka qenë anëtar i njësisë së Forcave Speciale të Policisë Serbe.

Në raportin e bastisjes së shtëpisë, realizuar në 1 Tetor 2001, që u lexua tek provat, nuk u gjend ndonjë provë të ndonjë uniforme ushtarake apo arme apo ndonjë shenjë tjetër dalluese të përfshirjes së tij në konfliktin e Marsit 1999.

Edhe në se kjo Gjykatë e merr me rezervë dëshminë dhe provat e paraqitura nga i akuzuari në mbrojtien e tij në përgjithësi, përsëri nuk mundi ta gjente të akuzuarin fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm për krime luftime kundër popullsisë civile. Sidoqoftë, kjo Gjykatë i mori në konsideratë provat e dëshmive dhe ato dokumentare të paraqitura nga i akuzuari dhe mbrojtia e tij, dhe shfrytëzon këtë rast të vejë në dukje skepticizmin e saj ndaj provave. Së pari, fakti që të akuzuarit i ishte dhënë një uniformë dhe armë permby një vit më parë se të ndodhnin veprat penale të supozuara në aktakuze, bën sigurisht të mundshme pjesëmarrjen e të akuzuarit në veprat e përmendura, edhe në ato më të hershmet, sic ishte ajo e 25 Marsit. Së dyti, kjo Gjykatë e gjen të cuditëshme atë që i akuzuari nuk ka ruajtur asnjë tregues të shërbimit të tij ushtarak. Së treti, megjithëse janë edhe të tjerë Sasa Grkovic në rajon, provat tregojnë se asnjëri prej tyre nuk ka ngjashmëri me të akuzuarin. Së fundi, kjo Gjykatë e gjen të pakonceptueshme atë që i akuzuari, apo cdo njëri që jetonte në Rajonin e Prizrenit, Kosovë, të mos kishte dijeni fare për më se dy vjet për masakrat e kryera kundër popullsisë civile gjatë luftës, sidomos nën jehonën e proceseve gjyqësore të krimeve të luftës para këtij procesi.

Pavarësisht nga skepticizmi i Gjykatës kundrejt dëshmive dhe provave të paraqitura nga i akuzuari, provat e paraqitura të ndjekies thjesht nuk provojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se ishte i akuzuari, Sasa Grkovic, që kreu apo ishte pjesëmarrës në veprat penale të pretenduara.

### **3. Veprat që ngarkohet i akuzuari në Mamushë në 27 Mars 1999.**

Aktakuza në menyrë specifike pretendon se në 27 Mars 1999, i akuzuari, ndërsa bënte pjesë në një grup prej gjashtëmbëdhjetë personash të uniformuar të efektivit Serb vrau qëllimisht katër Shqiptarë të Kosovës: R [REDACTED] S [REDACTED] Shaban S [REDACTED] Sulejman S [REDACTED] dhe Muharrem S [REDACTED]. Aktakuza nuk paraqet hollësira për sa i përket pjesëmarrjes së supozuar të Grkovicit në këto akte.

E vetmja dëshmitare që dëshmon për këto supozime kundër të akuzuarit në Mamusha, ishte Zarrife Sadiku. Kjo Gjykatë vëren se është plotësisht e arsyeshme që Gjykata të mbështetet në dëshminë e një dëshmitari të vetëm mbi një fakt material pa nevojën e vërtetimit.

Zj. S [REDACTED] është një grua e vjetër rreth 63 vjec, me sëmundje të zemrës. Ajo dëshmoi në gjyq nën kujdesin e profesionistëve mjekësorë që mbikëqyrnin gjëndjen e saj. Zj. S [REDACTED] dëshmoi në hollësira relative rreth barbarisë së kryer në fshatin e saj në Mamushë në 27 Mars 1999. Atë ditë u vranë nga forcat Serbe katër anëtarë të familjes së saj, nga të cilët tre ishin djemtë e saj dhe njëri ishte djali i kunatit të saj. Zj. S [REDACTED] deklaroi se ishin rreth 16 policë Serbë në oborrin ku u vranë djemtë e saj. Ajo deklaroi gjithashtu se uniformat e veshura nga forcat Serbe ishin të ndryshme dhe disa kishin lyer fytyrën me bojë. Zj. S [REDACTED] në fakt, nuk i pa të shtënat, por ajo mundi të dëgjojë breshëritë e të shtënave pak minuta mbasi u largua nga oborri dhe ishte duke ecur, sic ishte urdhëruar nga Policët Serbë.

Zj. S. [REDACTED] deklaroi se ajo ishte afërsisht katër metra larg nga nje polic që shkoi tek djali i saj në fillim, dhe se ajo e shikoi atë me vëmendje për të parë se çfarë po bënte ai me djalin e saj. Ajo deklaroi se ai kishte veshur uniformë të kamufluar. Ishte ky polic që Zj.S. [REDACTED] identifikoi më pare si të akuzuarin, por duhet të theksohet se ajo nuk mundi ta identifikojë atë në sallën e gjyqit gjatë gjykimit kryesor.

Nuk ka asnjë diskutim se anetarët e familjes së Zj.S. [REDACTED] u vranë nga forcat Serbe. E vetmja pyetje që mbetet është se nëse identifikimi i të akuzuarit nga Zj.Sadiku është provë serioze, e tillë që kjo të gjehet nga Gjykata “përtej dyshimit të arësyeshëm” se i akuzuari është fajtor për krime lufte kundër popullsisë civile për këto vrasje.

#### **a. Identifikimi i te akuzuarit**

Dëshmia e dëshmitares pamore S. [REDACTED] është e pa qëndrueshme dhe e pambështetur. Zj.S. [REDACTED] deklaroi se asaj i janë treguar së paku në dy apo tre raste të mëparshme për qëllime identifikimi, dosjet që përmbanin rreth 250 fotografi personash, dhe se ajo kishte identifikuar të akuzuarin, Sasa Grkovic, që ishte me forcat Serbe që vranë djemtë e saj. Për fat të keq, nuk ka raporte të tilla që të konfirmojnë këtë gjë. Gjykata vëren se disa shënime të KFOR-it konfirmojnë se së paku një dëshmi është marrë nga Zj.S. [REDACTED] dhe se ajo identifikoi të akuzuarin. Megjithatë, nuk janë paraqitur prova për sa i përket përmbajtjes që shoqëroi procesin e identifikimit të fotografive, përshembull, çfarë fotografish i ish in treguar Zj.S. [REDACTED] kur i janë treguar asaj fotografitë, çfarë i ishte thënë asaj dhe çfarë përgjigje kishte dhënë ajo, apo ndonjë lloj përshkrimi të pavarur të kryerësit të krimit të dhënë nga dëshmitarja.

Provat e paraqitura tregojnë se Zj.S. [REDACTED] mori pjesë në shikimin e një rreshtimi personash për identifikim në 20 Gusht 2001 në Kampin Phoenix dhe e përshkroi të dyshimtin si të gjatë dhe të dobët, dhe më pas ajo identifikoi të akuzuarin S. [REDACTED] G. [REDACTED]. Procesverbali i dëgjimit të asaj dite i Zj.S. [REDACTED] nuk tregon saktësisht se çfarë i ishte thënë asaj përpara se të shikonte personat e rreshtuar.

Një vit më vonë, gjatë gjykimit kryesor Zj. S. [REDACTED] u pyet për të identifikuar personin që ajo kishte parë në Mamushë në 27 Mars 1999. Megjithatë, ajo nuk mundi të identifikonte asnjë person dhe e përshkroi kryerësin e krimit të ishte zeshkan dhe jo shume i madh, thjesht normal-përshkrim i cili dallon thellësisht nga i akuzuari.

Të marra së bashku, procesi hetimor dhe identifikimi pasues i të akuzuarit nga ana e Zj.S. [REDACTED] është qenësisht i pabazuar. Së pari, nuk tregohet se si janë treguar fotografitë Zj.S. [REDACTED] dhe se çfarë i është thënë asaj edhe mbasi perfundoi. Është vetëm një koment i shkurtër për marrjen e një dëshmie të vetme. Nuk ka raport për atë dëshmi, pa përmendur për ndonjë raport të ndonjë tregimi tjetër të fotografive. As nuk mundet që të provohet në se një rreshtim fotografish i është treguar në mënyrë të drejtë dhe jo sugjestive. Për më tepër, fakti që dëshmitares i është kërkuar të shikojë fotografitë në dy apo tre raste të vecanta, i tregon Gjykatës se rreshtimi i fotografive ishte sugjektiv.

Së dyti, megjithëse dëshmitarja e identifikoi të akuzuarin gjatë rreshtimit për identifikim të personave, janë disa probleme që kanë të bëjnë me pa anësinë dhe saktësinë e rreshtimit, sic u diskutua dhe më lart. Në mënyrë të vecantë, nga dëshmia e Zj.S. [REDACTED] e datës 20 Gusht 2001, del se ajo thjesht identifikoi personin që ajo kishte identifikuar më parë në fotografi. Dëshmia e saj se “policia më tregoi mua fotografi dhe unë kam përshtypjen se e kam identifikuar të dyshimtin”, nënkupton se ajo besonte nga Policia se ajo kishte identifikuar saktësisht të dyshimtin e tyre, në vënd që thjesht të identifikonte personin që ajo pa në masakrën e Mamushes. Përveç kësaj, nuk ka shenja që tregojnë në se asaj i ish in dhënë udhëzime nga ana e gjykatësit hetues, në se ndonjë i tillë i ishte dhënë, për të siguruar një identifikim të drejtë dhe të

saktë. Fakti që dëshmitarja deklaroi në gjykim se gjykatësi hetues vetëm i tha asaj të shikonte në rresht dhe të tregonte atë që ajo besonte se e kishte kryer krimin, të bën të besosh se ajo nuk ishte udhëzuar se i dyshimti mundet të mos ishte në atë rreshtim. Nëse dëshmitarja nuk u udhëzua ka plotësisht të ngjarë që ajo të mendonte se i dyshimti ishte vërtet njëri nga të gjashtë personat në rreshtim dhe ajo zgjodhi më të mundshmin ose, madje ka më shumë të ngjarë, atë që ajo e kishte njohur në fotot e mëparshme. Krahas kësaj, përbërja e rreshtimit ishte sugjestive. Personat e përfshirë në rreshtim ishin ushtarë të ushtrisë gjermanë, shumica e të cilëve dukeshin me peshë më të madhe dhe më të shëndoshë se i akuzuari, i cili kishte qenë në paraburgim në atë kohë për rreth tre muaj. Kur kryhet në këtë mënyrë, është e lehtë të zgjedhësh të dyshimtin më të ngjashëm sesa personin e vërtetë që ajo kishte parë me forcat serbe në Mamusa.

Së treti, kur u udhëzua nga Gjykata në shqyrtim që të shihte në sallën e gjyqit për të parë nëse mund ta identifikonte të akuzuarin, ajo nuk arriti ta identifikonte atë. Theksojmë që gjykata e udhëzoi gjithashtu se personi që ajo kishte parë në masakrën në Mamusa mund edhe të mos ishte në sallën e gjyqit.

Megjithëse Znj. S██████ deklaroi që e kishte parë mirë këtë person me djalin e saj, është e qartë se identifikimi i të akuzuarit prej saj nuk ishte i sigurtë sipas rrethanave të përshkruara më lart. Gjykata do të nënvizonte vështirësitë që shoqëronin identifikimin e një personi ndër 16 personat që ajo kishte parë në Mamusa, shumë prej të cilëve i kishin fytyrat të lyera me bojë, dhe që po e sulmonin familjen e saj me fjalë dhe fizikisht. Në të vërtetë, Znj. S██████ dëshmoi që burri i saj, i cili ishte edhe ai prezent në atë kohë dhe foli drejtpërdrejt me personelin serb, asnjëherë nuk e identifikoi të akuzuarin.

Marrë në tërësi, për këtë akuzë ka një mungesë serioze dëshmie të identifikimit të sigurtë. Prandaj Gjykata nuk mundi të gjejë pa asnjë dyshim të arsyeshëm se Grkovic është fajtor për pjesëmarrje në aktet që pretendohet të jenë kryer në Mamusa.

#### 4. Aktet e supozuara në Bella Cerke më 25 Mars 1999.

Aktakuza deklaroi se më 25 Mars 1999, i akuzuari Sasa Grkovic, duke qenë anëtar i efektivit serb në uniformë në afërsi të Bella Cerkes, mori pjesë në shkatërrimin e paarsyeshëm të shtëpive dhe pasurisë, dëbimin forcërisht të fshatarëve, dhe mori pjesë në një masakër të 65 civilëve të paarmatosur në Ura e Ballajes, duke hapur zjarr mbi ta me armë automatike, përfshirë N██████ P██████ A██████ P██████ dhe Sh██████ P██████

Një numër dëshmitarësh dëshmuan në lidhje me këtë akuzë kundër të akuzuarit, përfshirë F██████ P██████ S██████ P██████ Z██████ P██████ I██████ Zh██████ D██████ P██████ dhe Sh██████ G██████ Përsa u përket ngjarjeve të veçanta të kësaj tragjedie, të gjithë dëshmitarët priren të jenë pothuajse konsekuentë dhe nuk ka dyshim që ngjarjet kanë ndodhur. Në mënyrë të veçantë, dëshmitarët përshkruan mbërritjen herët në mëngjes të forcave serbe që dogjën shtëpitë në fshat dhe morën sendet e çmuara, si dhe dy ngjarjet kryesore që përfshinë këtë masakër të civilëve.

##### a. Masakra ndaj Familjeve S██████ dhe Zh██████

E para ishte vrasja e dy familjeve në një farë largësie nga ura. Në këtë masakër, 13 pjesëtarë të familjeve të Gj██████ S██████ dhe C██████ Zh██████ u vranë në duart e forcave serbe. I██████ Zh██████ dëshmoi se kishte dëgjuar rafallën e të shtënave në lidhje me vrasjen e këtyre familjeve, por nuk e kishte parë. S██████ P██████ në fillim dëshmoi se kishte qenë afërsisht 80 metra larg kur policia serbe kishte vrarë familjet S██████ dhe Z██████ dhe më vonë dëshmoi në

vendngjarje se ishte afërsisht 150 metra. Në shqyrtim, S [redacted] P [redacted] shtoi se kishte patur dylbi me vete atë ditë dhe kishte parë se ishte i akuzuari ai që kishte vrarë familjet S [redacted] dhe Zh [redacted]

#### b. Masakra në Urën e Bellajes.

S [redacted] P [redacted] dëshmoi se i njëjti grup i policisë serbe kishte shkuar më pas tek hekurudha dhe kishte vrarë grupin e burrave shqiptarë te Ura e Bellajes. Megjithatë, S [redacted] P [redacted] pranon se nuk e ka parë masakrën konkretisht.

I [redacted] Zh [redacted] një ndër të mbijetuarit e paktë të masakrën në Urën e Bellajes, dëshmoi në shqyrtim se rreth 15 policë serbë të veshur me uniforma maskimi i kishin rrethuar burrat dhe gratë dhe kishin ndarë burrat veçan. Grave iu tha të shkonin në Xerxe. Burrat ishin urdhëruar të zhvishnin rrobat. Forcat serbe u kishin marrë paratë, i kishin bastisur dhe i kishin rrahur. Ai deklaroi në shqyrtim se një person, N [redacted] M [redacted] kishte goditur me çizme djalin e axhës së tij në kokë, duke i thyer kafkën. Edhe Z. Zh [redacted] dëshmoi se N [redacted] M [redacted] i kishte marrë djalin dhe e kishte hedhur në hekurudhë. Së fundi, dy grupe burrash në të dy anët e lumit i kishin bashkuar me njëri-tjetrin. Z. Zh [redacted] dëshmoi se i akuzuari ishte njëri prej policëve serbë dhe ai kishte marrë djalin e S [redacted] P [redacted] (A [redacted] P [redacted] nga krahët e nënës së vet (F [redacted] P [redacted] dhe kishte qëlluar me armë dhe kishte vrarë Sh [redacted] P [redacted] dhe axhën e tij, N [redacted] I [redacted] Menjëherë pas kësaj, të gjithë burrat ishin urdhëruar të shkonin në lumë dhe policia serbe i kishte qëlluar të gjithë në shpinë ndërkohë që po ecnin drejt lumit. Ata fshatarë që dukej se ishin ende gjallë ishin qëlluar përsëri në afërsi. I [redacted] Zh [redacted] ishte një ndër 8 apo 9 të mbijetuarit. Në rastin e tij, ai ishte fshehur nën disa kufoma pranë një shkëmbi dhe kishte arritur të jetonte megjithëse ishte qëlluar në shpatull. Masakrat që përshkroi Z. Zh [redacted] nuk vihen në dyshim. Për fat të keq, dëshmia në shqyrtim e Z. Zh [redacted] vihet në pikëpyetje në lidhje me identifikimet e tij, pasi ai ka identifikuar disa njerëz të ndryshëm që ai beson se kanë vrarë N [redacted] dhe Sh [redacted] P [redacted] dhe e njëjta gjë vlen edhe për identifikimin nga ana e tij të personit që i vrau djalin e axhës, siç përshkruhet më poshtë.

F [redacted] P [redacted] dëshmoi se, megjithëse nuk e kishte parë masakrën konkretisht, kishte parë ngjarjet që kishin shpënë në masakër. Gjithashtu ajo përshkroi sesi i kishin marrë djalin, A [redacted] P [redacted] dhe pretendoi se personi që i kishte marrë djalin ishte i akuzuari, S [redacted] G [redacted]

Një dëshmi e ngjashme erdhi nga një i mbijetuar tjetër, Z [redacted] P [redacted] që gjithashtu i kishte shpëtuar masakrës. Megjithatë, Z [redacted] dëshmoi se N [redacted] dhe Sh [redacted] P [redacted] ishin vrarë nga dy persona. Po kështu, ai dëshmoi se A [redacted] P [redacted] ishte marrë nga nëna e tij, F [redacted] P [redacted] nga disa policë serbë. Ai mendonte se personi që kishte marrë A [redacted] ishte i gjatë, por nuk ishte i sigurtë nëse mund ta njohte.

Dëshmia e mësipërme lidhur me masakrën vërtetohet edhe nga dy fshatarë në moshë më të re, D [redacted] P [redacted] dhe Sh [redacted] G [redacted] të cilët kishin arritur t'u fshiheshin forcave serbe. D [redacted] P [redacted] kishte mundur të fshihej prapa urës rreth 10 metra më tutje para se të nisnin të shtënat dhe e kishte parë ngjarjen. Ai përshkroi se N [redacted] dhe Sh [redacted] ishin qëlluar, por nuk kujton nëse mbi ta kishte shtënë një polic apo dy policë. Megjithatë, ai deklaroi se kishte patur mundësinë të shihte njaft mirë forcat serbe, të cilat kishin veshur uniforma maskimi dhe i akuzuari nuk ishte në radhët e tyre.

Në mënyrë të ngjashme, Sh [redacted] G [redacted] lha një dëshmi të hollësishme lidhur me ngjarjet. Ai vërtetoi dëshminë e dëshmitarëve të tjerë për këto ngjarje. Z. G [redacted] ishte përfshirë në grupin e burrave dhe e përshkroi policinë serbe të veshur me uniforma maskimi dhe disa i kishin lyer fytyrat me bojë. Ai kishte dëshmuar pushkatimin e N [redacted] dhe Sh [redacted] P [redacted] dhe dëshmoi se ata ishin vrarë nga dy policë të ndryshëm. Z. G [redacted] përshkroi personin që shtiu mbi N [redacted] si të shëndoshë dhe shumë të ngathët. Personi që kishte qëlluar Sh [redacted] ishte i ri dhe e kishte

fytyrën të lyer me bojë. Ai deklaroi se kishte qenë i fundit kur ata kishin nisur të shtinin dhe kishte patur mundësinë të kërcente brenda në përrua dhe të kalonte në anën tjetër të urës pa u vënë re. Z. G. nuk qe në gjendje ta identifikonte të akuzuarin as nga dosja e fotove të Njesisë së Hetimeve të Sjelljes Kriminale (“dosjet e CCIU-t,” të hartuara menjëherë pas luftës dhe që përmbanin 330 foto, përfshirë një foto të të akuzuarit), as në sallën e gjyqit.

### c. Identifikimi i të akuzuarit

Kjo Gjykatë përballet me shumë dëshmi kontradiktore lidhur me atë nëse i akuzuari ka qenë në masakër, krahas dëshmive kontradiktore se kush i vrau N. dhe Sh. P. Gjykata duhet ta shohë këtë dëshmi si të tërë, me qëllim që të përcaktojë nëse mund të gjejë përtej dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari ishte fajtor për krime lufte.

I. Z. duket se është dëshmitari tek i cili është mbështetur më shumë Prokurori Publik Ndërkombëtar, megjithë mospërputhjet e shumta në dëshminë e tij dhe një paaftësie të qartë për t'i dhënë Gjykatës një dëshmi objektive dhe të gjallë të masakrave dhe të atyre personave që ai kujtoi të ishin përfshirë. Kjo mbështetje kaq e madhe në dëshminë pabesmueshmërisht kundërthënëse të një dëshmitari është e pa vënd.

I. Zh. dëshmoi në shqyrtim se ishte marrë në pyetje shumë herë, përfshirë gazetarët dhe ICTY-në dhe identifikoi të akuzuarin si personin që kishte vlarë N. dhe Sh. P. Z. Zh. ballafaqua me dëshminë në KFOR më 17 Shtator 1999, ku është e paqartë nëse ai identifikoi Sasa Grkovic apo N. I. K. si autorin e supozuar. Më 27 Shtator 1999, dëshmia në KFOR, Z. Zh. tha se K. dhe Grkovic kishin qenë të pranishëm gjatë të shtënave, por nuk i pa të hapnin zjarr mbi ndonjë njeri. Në shqyrtim Z. Zh. u ballafaqua edhe me dëshmitë kontradiktore të tij të dhëna vetëm një muaj më pas. Ndërsa dëshmitari nuk mbante mend t'u kishte thënë hetuesve më 28 tetor 1999 se ai që kishte vlarë Sh. dhe N. P. kishte qenë D. B. ai pranoi që mund t'u kishte thënë më 1 nëntor 1999 se ai që kishte vlarë Shendet dhe Nesim Popajn kishte qenë komandant M. A. D.

Z. Zh. u ballafaqua edhe me dëshmitë e tij para policisë së UNMIK-ut. Më 1 Mars 2000, atij iu dha mundësia të rishikonte dosjet e CCIU-t, që kjo Gjykatë vërtetoi se ishin të njëjtat dosje të sjella në Gjykatë, dhe ai nuk e identifikoi policin që vrau N. dhe Sh. P. Përpos kësaj, ai nuk e identifikoi asnjëherë S. G. as si person që kishte qenë në masakër. Le t'i shtojmë dëshmisë konfuze të identifikimit edhe atë që në Qershor 2001, hetuesi i policisë së UNMIK-ut, John Eisler, raportoi se i kishte treguar Z. Zh. një renditje prej 6 fotosh njëra prej të cilave përfshinte Sasa Grkovicin dhe ai nuk kishte qenë në gjendje ta identifikonte. Më pas, gjatë një rreshtimi personash më 20 Gusht 2001, Z. Zh. deklaroi se i kishte thënë gjyqtarit hetues se policia i kishte treguar atij foto dhe se ai kishte identifikuar Sasa Grkovicin nga një foto bardhë e zi si person që kishte qenë te Ura e Ballajes. Z. Zh. vazhdoi me identifikimin e Sasa Grkovicit në rreshtimin me njerëz si personin që kishte marrë djalin e tij dhe e kishte hedhur në shinat e hekurudhës. Z. Zh. dëshmoi se, pasi ishte larguar nga rreshtimi i identifikimit, ai kishte humbur vetëdijen dhe, megjithëse e di që foli me dikë, ai nuk e di se çfarë i kishte thënë. Ai ishte shtruar në spital për dhjetë ditë dhe shpjegoi se kjo gjendje i ishte shkaktuar nga mundimi i asaj që kishte përjetuar dhe nga ballafaqimi me traumën e kaluar në rreshtimin e identifikimit. Më vonë, në Qershor 2002, kur dha dëshmi para ICTY, Z. Zh. i tha Gjykatës se N. dhe Sh. P. ishin vlarë nga një polic i rregullt. Së fundi, në shqyrtim, Gjykata i tregoi Z. Zh. dy dosjet origjinale të fotove të CCIU-t dhe ai deklaroi se

nuk kujtonte t'i ishin treguar ndonjëherë më parë këto foto, edhe pse është e qartë se këto foto i ishin treguar Z. Zh[REDACTED] të paktën më 1 Mars 2000 nga policia e UNMIK-ut.

Krahas pësjtjellimit për atë se kush i vrau Sh[REDACTED] dhe N[REDACTED] P[REDACTED], dëshmia e Z. Zh[REDACTED] është po aq konfuze edhe në lidhje me personin që i kishte marrë djalin dhe ia kishte hedhur në shinat e trenit. Në deklaratën e dhënë para gjyqtarit hetues më 20 Gusht 2001, ai kishte dëshmuar se ishte absolutisht i sigurtë se kishte qenë i akuzuari ai që i kishte marrë atij djalin dhe ia kishte hedhur në shinat e trenit. Krejt ndryshe, në shqyrtim ai dëshmoi se kishte qenë N[REDACTED] M[REDACTED] ai që i kishte marrë atij djalin dhe ia kishte hedhur në shinat e trenit.

Duke patur parasysh këtë dëshmi pabesueshmërisht të pësjtjelluar, është e pakonceptueshme që kjo Gjykatë të mund të mbështetet tek dëshmia e I[REDACTED] Zh[REDACTED] madje edhe lidhur me faktin nëse i akuzuari kishte qenë në masakër, jo më nëse ishte personi që kishte vrarë Sh[REDACTED] dhe N[REDACTED] P[REDACTED]. Para kësaj Gjykate nuk ka absolutisht asnjë provë që të demonstrojë se çfarë kontrolli është vendosur, nëse po, në rreshtimet e fotove që i janë treguar Z. Zh[REDACTED] për të siguruar që identifikimet të ishin të drejta, të pavarura, madje edhe të raportuara me saktësi. Asnjë foto nuk u ishte bashkagjitur raporteve që të tregonin se çfarë i ishte treguar dëshmitarit ose çfarë fotosh ishin zgjedhur. Për më tepër, me kaq shumë identifikime fotosh të ndryshme që i ishin treguar Zotit Zh[REDACTED] kaq shumë herë të ndryshme dhe nga kaq shumë hetues ushtarakë, policie dhe ndërkombëtarë, është e pamundur të thuhet nëse ndonjëri prej këtyre identifikimeve mund të konsiderohet "i pavarur". Kjo nuk do të thotë që kjo Gjykatë nuk e pranon mundësinë që Z. Zh[REDACTED] të mendojë se i akuzuari ishte në masakër. Në të vërtetë, duke patur parasysh traumën që përjetoi Z. Zh[REDACTED] dhe pasojat e rënda që ajo ka patur në shëndetin e tij, deri në atë pikë sa ai të mos mbajë mend se çfarë ka thënë në rreshtimin e njerëzve dhe më pas u desh të dërgohej në spital, nuk është për t'u habitur që dëshmia e identifikimit e Z. Zh[REDACTED] është e pësjtjelluar. Megjithatë, ky fakt kontribuon vetëm në pasigurinë e qenësishme të identifikimit të të akuzuarit nga ana e tij. Sigurisht, në këto rrethana, këtyre identifikimeve nuk mund t'u jepet shumë peshë nga kjo Gjykatë.

Z[REDACTED] P[REDACTED] dëshmoi se më parë kishte identifikuar 16 persona të pranishëm në masakër, përveç njërit. Asnjëri nuk përfshiu të akuzuarin, Sasa Grkovic. Gjatë seancës së parë të dëshmisë së tij, Z. P[REDACTED] iu kërkua të shihte brenda sallës së gjyqimit për të parë nëse mund të gjente ndokënd që kishte qenë prezent në masakër dhe ai nuk arriti të gjente asnjë. Nënvizohet se, gjatë procedurës së identifikimit në sallën e gjyqimit, Z. P[REDACTED] tregoi babain e të akuzuarit, I[REDACTED] Grkovic, dhe deklaroi se ai e di se ishte djali i tij ai që e kishte kryer krimin tek Ura e Bellajes. Megjithatë, ai nuk arriti të tregonte të akuzuarin në sallën e gjyqit, edhe pse ky ishte ulur ngjitur me avokatin mbrojtës të tij. Nga ky incident Gjykata nuk mund veçse të arrijë në përfundimin që identifikimi i Z. P[REDACTED] nuk mbështetet në asgjë më shumë përveç se që ka dëgjuar se i akuzuari ka marrë pjesë në krime. Megjithëse Z. P[REDACTED] pretendoi se nuk mund të shihte mirë pa syzet e tij, ai sqaroi se syzet i nevojiteshin vetëm për të parë afër. Në seancën e dytë të dëshmisë së tij në shqyrtim, Z[REDACTED] P[REDACTED] rishikoi dosjet e CCIU-t duke përdorur syzet e tij. Ai deklaroi se i kujtohej t'i kishte parë këto dosje më parë. Megjithë faktin se nuk e kishte identifikuar të akuzuarin asnjëherë më parë, Z. P[REDACTED] identifikoi atë ditë foton e të akuzuarit si të pranishëm në masakër. Megjithatë, Gjykata nuk mund ta gjejë këtë identifikim të sigurtë në njëfarë mënyre pasi ai ishte rezultat i përcaktimit më në fund të identitetit të të akuzuarit gjatë procesit gjyqësor.

Megjithëse S[REDACTED] P[REDACTED] dëshmoi në shqyrtim se kishte parë të akuzuarin të vriste familjet S[REDACTED] dhe Zh[REDACTED] është e vështirë t'i japësh peshë të madhe dëshmisë së tij për disa arsye. Pikësepari, S[REDACTED] P[REDACTED] kishte dëshmuar disa herë para dëshmisë së tij në shqyrtim dhe nuk kishte deklaruar asnjëherë më parë se kishte patur dylbi me vete. Megjithatë, para ICTY dëshmoi se ditën e masakrës mbante dylbi. Prapëseprapë, edhe sikur Gjykata të besojë se ai kishte dylbi, S[REDACTED] P[REDACTED] dëshmoi në vendngjarje se largësia nga e cila kishte qëndruar dhe

kishte parë masakrën ndaj familjeve S [redacted] dhe Zh [redacted] ishte afërsisht 150 metra më tutje. Në vendngjarje u demonstrua se edhe me dylbi një person nuk mund të shihet me hollësi nga një largësi e tillë.

Dëshmia në Gjykatë e F [redacted] P [redacted] është e mbushur me deklarata që vërtetojnë pamundësinë e saj për të shikuar mirë policinë Serbe që rrethoi dhe masakroi fshatarët në Urën e Bellajes. Kur u pyet se sa njerëz e kishin rrethuar fshatin, ajo deklaroi se nuk e dinte sepse "Askush nuk guxonte të shihnte fytyrat e tyre." Kur u pyet për llojin e uniformave të veshura nga forcat serbe, ajo deklaroi se ishte tepër e trembur dhe nuk vuri re. Gjithë kjo tregon një pamundësi për të qenë vërtet në gjendje për të parë autorët e krimit dhe për të qenë në gjendje për t'i identifikuar ata. Gjithësesi, Znj. P [redacted] dëshmoi në shqyrtim se e kishte identifikuar më parë Grkovicin si personi që i kishte marrë djalin dhe kur u pyet se sa foto i ishin treguar, ajo deklaroi, vetëm një. Në rreshtimin e identifikimit të njerëzve, Znj. P [redacted] ishte e sigurtë për zgjedhjen prej saj të personit që i kishte marrë djalin. Megjithatë, ajo nuk e identifikoi të akuzuarin. Përsëri, kjo Gjykatë e ka të qartë se identifikimi i të akuzuarit nga kjo dëshmitare është thjesht i pasigurtë pasi duket se ajo nuk e ka parë mirë personin që mori djalin prej saj sepse ishte tepër e trembur, por edhe për shkak të natyrës qartazi sugjestive të procesit të identifikimit të fotove nga KFOR-i dhe faktit se ajo nuk mundi ta identifikojë të akuzuarin më vonë.

Dëshmitë më te forta dhe të besueshme vijnë nga D [redacted] P [redacted] dhe Sh [redacted] G [redacted] të cilët ishin rreth 15 vjeç në atë kohë dhe patën mundësinë të fshiheshin e të shihnin masakrën. D [redacted] P [redacted] që në gjendje të shihte masakrën nga një largësi prej jo më shumë se 20 metra. Në hetimin në vendngjarje u tregua pa asnjë dyshim se pamja e tij nga ku ishte fshehur prapa urës ishte krejt e papenguar. Në shqyrtim ai dëshmoi se mund të shihnte fytyrat e oficerëve kur burrat ishin ndarë nga gratë. Atij iu tregua dosja me foto e CCIU-t dhe njohu disa prej fotove, por nuk e njohu të akuzuarin në fotot. Kur iu kërkua të shihnte posaçërisht të akuzuarin dhe t'i tregonte Gjykatës nëse ai kishte qenë në masakër ose nëse kishte qenë njëri prej atyre që kishin djegur shtëpitë, ai në mënyrë të theksuar deklaroi se i akuzuari nuk kishte qenë atje.

Gjykata nënvizoi se Z [redacted] P [redacted] u përpoq të skualifikonte dëshminë e D [redacted] P [redacted] duke thënë se ai kishte frikë dhe/ose as kishte qenë në vendin e ngjarjes. Gjykata është e bindur se D [redacted] P [redacted] ka qenë vërtet i pranishëm gjatë masakrës dhe është një dëshmi shumë e paanshme dhe plotësisht e vërtetë. Si provë e kësaj, dëshmia e D [redacted] P [redacted] në vendngjarje vërtetoi çdo hollësi të deklaruar në seancën e shqyrtimit kryesor. Për më tepër, nuk ka arsye të besohet se D [redacted] P [redacted] dëshmitari kryesor kundër J [redacted] duhej të kishte frikë nga i akuzuari.

Këtu duhet të trajtohet një çështje e ngritur nga prokurori publik ndërkombëtar në lidhje me vërtetësinë e këtij dëshmitari. Prokurori publik ndërkombëtar argumentoi se dëshmia e D [redacted] P [redacted] nuk ishte e besueshme sepse ai deklaroi se policia Serbe kishte qëlluar drejt tij nga silloset ndërsa ai ishte tek Ura e Bellajes. Interpretimi i dëshmisë së tij nga prokurori publik ndërkombëtar është thjesht i pasaktë. Dëshmia e D [redacted] P [redacted] për Gjykatën tregon qartazi se nga cili drejtim erdhën të shtënat. Gjykata do të nënvizonte që disa dëshmitarë dëshmuan se ishin qëlluar nga drejtimi i silloseve dhe do t'i referohej veçanërisht dëshmisë së I [redacted] Zh [redacted] dhe S [redacted] P [redacted].

Për rrjedhojë, kjo Gjykatë i hedh poshtë akuzat e pabaza të Z [redacted] P [redacted] për D [redacted] dhe argumentin e prokurorit publik se dëshmia e D [redacted] P [redacted] përmbante mospërputhje të rëndësishme. Në vend të kësaj, dëshmisë së D [redacted] P [redacted] caktoi peshë të madhe për shkak të mundësisë së tij për të parë ngjarjet para dhe gjatë masakrës dhe sepse, nga dëshmia e tij si në shqyrtim ashtu dhe në vendngjarje, ishte e qartë se ai ishte shumë objektiv, i paanshëm dhe i hollësishëm në përshkrimin e ngjarjeve nga ana e tij.

Dëshmia e Sh. G. ishte njësoj bindëse. Më e rëndësishme në dëshminë e tij është faki që ai ishte njëri prej burrave të ndarë nga gratë dhe që u qëllua gjatë masakrës. Ai që në gjendje të fshihej gjatë procesit të të shtënave, pasi kishte qenë i fundit në radhë. Dëshmia e tij tregoi menjëherë se ishte e vështirë të shihje fytyrat e forcave serbe sepse shumë prej tyre i kishin fytyrat të ljera dhe sepse burrat u urdhëruan të ulnin kokat. Dëshmia e Z. G. demonstroi sa të vështirë e ka patur, duke qenë njëri prej burrave që u qëlluan, të shihte vërtet mirë forcat serbe përgjegjëse. Ai vetë nuk e identifikoi të akuzuarin si të pranishëm në masakër. Sh. G. dha edhe një përshkrim të njerëzve që vranë N. dhe Sh. P. që ishte krejt i kundërt me atë të dhënë nga Z. Zh. dhe që nuk e përshkruan të akuzuarin në asnjë mënyrë. Ai deklaroi se personi që kishte qëlluar N. ishte i shëndoshë dhe i ngathët dhe personi që qëlloi Sh. ishte i ri dhe e kishte fytyrën të ljer me bojë.

Prokurori publik ndërkombëtar argumenton në mënyrë jobindëse se dëshmia e Z. Gashi nuk është e besueshme sepse ai deklaroi se, "ata [policët serbë] hynë në përrua dhe shtinë mbi ne." Prokurori publik ndërkombëtar e mori dëshminë e tij jashtë kontekstit për të arritur në përfundimin e pasaktë se deri-diku kjo do të thoshte se fshatarët ishin qëlluar nga përpara dhe jo nga prapa, siç shpjegoi Z. G. në vendngjarje. Duke patur parasysh deklaratën e parë të Z. G. se "Unë isha personi i fundit në rresht dhe ata nisën të shtijnë mbi ne menjëherë," Gjykata nuk mund të shohë ndonjë lidhje logjike midis këtyre deklaratave dhe nëse ata u qëlluan nga përpara apo nga prapa. Kësisoj, Gjykata e hedh poshtë pohimin e prokurorit publik ndërkombëtar se kjo deklaratë nuk përputhet në asnjë drejtim me dëshminë tjetër të tij. Përsëri, ashtu si me D. P. kësaj Gjykate i bëri përshtypje se sa objektiv dhe i hapur ishte ky dëshmitar në dhënien e dëshmisë së tij dhe, për rrjedhojë, e gjeti atë shumë bindëse.

Gjykatës i kërkohet të shohë të gjitha dëshmitë dhe provat para saj dhe të vlerësojë besueshmërinë relative të dëshmive të dëshmitarëve pamorë në lidhje me mundësinë për t'i parë autorët e masakrave dhe në lidhje me aftësinë për të kujtuar ngjarjet dhe personat e përfshirë me objektivitet dhe me sinqeritet. Mendimi i kësaj Gjykate është se dëshmitë e D. P. dhe Sh. G. janë dëshmitë më bindëse. Dëshmitë e identifikimit të I. Zh. S. P., F. P. dhe Z. P. janë kaq të ngarkuara me mospërputhje dhe të bazuara në mundësi kaq minimale për t'i parë ngjarjet qartë, saqë dëshmitë e tyre bëhen qenësish të pasigurta. Kjo pasiguri vetëm shtohet nga mungesa e ndonjë kontrolli lidhur me hetimet e KFOR-it.

Ndërsa kësaj Gjykate i kujtohen vazhdimisht aktet e shëmtuara e të tmerrshme që ndodhën në Bella Cerke, është përgjegjësia e saj që të mos i shtojë padrejtësitë e kryera duke lejuar dënimin e një njeriu bazuar në dëshmi identifikimi në thelb të pasigurta dhe në dëshmi identifikimi të dyshimta, kur krahasohen me dëshminë shumë të besueshme dhe objektive të D. P. dhe Sh. G. Për rrjedhojë, kjo Gjykatë nuk mund të gjejë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm që i akuzuari është fajtor për Krime Luftë kundër Popullsisë Civile në lidhje me veprat kriminale të kryera në Bella Cerke.

## 5. Aktet e supozuara në Krushë të Vogël 26 Mars 1999

Aktakuza deklaroi se më 26 Mars 1999, i akuzari Sasa Grkovic ishte pjesëtar i një grupi të armatosur të një efektivit Serb me uniformë që rrethoi dhe mori peng mbi 100 shtetas të paarmatosur shqiptarë të Kosovës në fshatin Krushë e Vogël dhe i rreshtoi ata përkundër një muri dhe hapi zjarr mbi ta në mënyrë çnjerëzore dhe pa dallim, gjë që pati si pasojë një numër të ndjeshëm të vdekurish. Përsëri, në aktakuzë nuk jepen hollësi lidhur me aktet e kryera ose përfshirjen e të akuzuarit.



Megjithatë, prapë, vetëm një dëshmitar mbështet supozimet e këtij pretendimi kundër të akuzuarit. Në këtë rast, ky dëshmitar është S [REDACTED] Sh [REDACTED] Gjatë shqyrtimit, Z. Sh [REDACTED] kujton vetëm që në Mala Krusa, më 26 Mars 1999, në mëngjes u dogjën shtëpi dhe se ai vetëm pa dy të rinj me duart lart kundër një muri siç ishin urdhëruar nga J [REDACTED]. Ai nuk pa asnjëherë 100 fshatarë të rreshtuar kundër një muri. Megjithëse vërtet dëgjoji të shtëna kur po largohej nga fshati. Në fakt, ai deklaroi se u largua nga fshati në orën 9:30 të mëngjesit të datës 26 Mars 1999 dhe shkoi në Shqipëri dhe nuk u kthye deri më 3 Korrik 1999.

Dëshmia e Z. Sh [REDACTED] në shqyrtim vërtetohet nga deklarata e tij më 20 Gusht 2001, dhënë në lidhje me rreshtimin me njerëz. Aty Z. Sh [REDACTED] deklaroi se nuk e njohte të akuzuarin S [REDACTED] G [REDACTED] dhe se nuk e kishte parë asnjëherë më parë. Prandaj, ai nuk mundi ta identifikonte në rreshtim. Për më tepër, Z. Sh [REDACTED] deklaroi pa dyshim se nuk pa askënd të kryente ndonjë masakër. Dëshmia e Z. Sh [REDACTED] përputhet edhe me dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin J [REDACTED] / K [REDACTED] më 23 Maj 2001. Në atë rast, ai deklaroi gjithashtu se nga 5 të mbijetuar në masakër ishte informuar që atë ditë në Krushë të Vogël ishin vranë 108 persona.

Megjithëse dëshmia në shqyrtim dhe deklarata para gjyqtarit hetues të Z. Sh [REDACTED] përputhen plotësisht, ajo bie drejtpërdrejtë ndesh me një deklaratë të dhënë në KFOR më 27 Shtator 1999. Për pasojë, Gjykata e ballafaqoi me të drejtë dëshmitarin me këtë deklaratë. Ndër të tjera, deklarata e raportuar nga KFOR tregonte se dëshmitari e kishte parë J [REDACTED] të urdhëronte mbi 100 fshatarë të rreshtohen kundër një muri, ku dëshmitari kishte parë J [REDACTED] të shtinte mbi njerëzit e mbështetur për muri. Deklarata vazhdon të tregojë se dëshmitari e kishte parë J [REDACTED] të urdhëronte 13 persona të futeshin në një shtëpi dhe pastaj i kishte vënë zjarrin shtëpisë, duke i djegur të gjithë të gjallë. Deklarata tregonte gjithashtu se dëshmitari kishte identifikuar të akuzuarin Sasa Grkovic si të pranishëm gjatë të shtënave por që ai vetë nuk kishte qëlluar me armë. Kur u ballafaqua me këtë deklaratë, dëshmitari deklaroi me forcë se ajo ishte tërësisht e pasaktë. Ai nuk kishte thënë se kishte parë njerëzit të digjeshin të gjallë në shtëpitë e tyre dhe ai nuk kishte parë asnjëherë 100 njerëz të rreshtuar përballë një muri. Duke patur parasysh mohimin me forcë të kësaj deklarate të mëparshme të dëshmitarit dhe pa dëshminë nga hetuesit e KFOR-it, Gjykata mund vetëm të arrijë në përfundimin se hetimeve të KFOR-it u mungonte mjaft saktësia. Më tepër Gjykata është e detyruar t'i pranojë si dëshminë e dëshmitarit në shqyrtim, ashtu dhe deklaratën e tij para gjyqtarit hetues.

Përsëri, nuk diskutohet që në Krushë të Vogël ndodhi një masakër. Ngjarjet janë të dokumentuara mirë. Megjithatë, nuk ka prova që të tregojnë nëse i akuzuari Sasa Grkovic ka qenë ndonjëherë i pranishëm në këtë masakër. Edhe prokurori publik ndërkombëtar e pranon mungesën e provave. Pa prova përveç atyre të përshkruara më lart, Gjykata është e detyruar të arrijë në përfundimin se nuk ka prova të mjaftueshme dhe nuk mund ta gjejë të akuzuarin fajtor për Krime Lufte kundër Civilëve më 26 mars 1999 në fshatin Mamusa.

## **6. Aktet e supozuara ndaj fshatarëve të Celines dhe Nogavacit më 26 Mars 1999 dhe aktet e supozuara në Celine më 28 Mars 1999**

Aktakuza supozon se më 26 Mars 1999 i akuzuari Sasa Grkovic mori pjesë si anëtar i një grupi të armatosur dhe me uniformë të efektivit serb në masakrën kundër civilëve shqiptarë të Kosovës në fshatin Celine.

Si pretendim të veçantë, aktakuza deklaroi se më 28 Mars 1999, i akuzuari Sasa Grkovic, duke veshur një uniformë maskimi dhe duke mbajtur një pushkë automatike, ishte në një grup të madh personeli Serb me uniformë që shkatërruan me dashje dokumentat e identitetit dhe u grabitën fshatarëve të Celines dhe Nogavacit paratë dhe sendet e tjera të çmuara nën

grykën e pushkës. Përsëri, aktakuza nuk jep hollësi të akteve të supozuara, ose të akteve të supozuara të të akuzuarit.

Dëshmitarët e thirrur për të dëshmuar lidhur me pretendimet për Celinën më 26 mars dhe 28 mars përfshijnë N [REDACTED] R [REDACTED] R [REDACTED] D [REDACTED] N [REDACTED] R [REDACTED] dhe H [REDACTED] G [REDACTED] N [REDACTED] R [REDACTED] R [REDACTED] D [REDACTED] dhe N [REDACTED] R [REDACTED] dëshmuar lidhur me ngjarjet në C [REDACTED] ndërsa H [REDACTED] G [REDACTED] u thirr për të dëshmuar lidhur me ngjarjet e ndodhura në Nogavac.

#### a. Nogavac

Në lidhje me veprimtaritë e pretenduara të ndodhura në Nogavac, H [REDACTED] G [REDACTED] kishte bërë më parë një deklaratë para KFOR-it, që nuk është e dokumentuar. G [REDACTED] i cili nuk u arrit të thirrej e të gjendej, ishte gjithashtu njëri prej dëshmitarëve të marrjes në pyetje në rreshtimin me njerëz, por meqë marrja në pyetje nuk ishte nënshkruar nga gjyqtari hetues, proces-verbali ishte i papranueshëm si dëshmi. Për pasojë, nuk ka dëshmi të pranueshme që do të trajtonte edhe hollësitë e grabitjeve të supozuara në Nogavac. Megjithatë, kjo Gjykatë do të nënvizonte se dokumentacioni i rreshtimit të njerëzve është në lëndë dhe tregon se Z. G [REDACTED] nuk ishte në gjendje ta identifikonte të akuzuarin në rreshtimin me njerëz. Pa asnjë dëshmi lidhur me grabitjet e supozuara të ndodhura në Nogavac dhe pa një identifikim pozitiv të të akuzuarit në lidhje me këto grabitje të supozuara, kjo Gjykatë nuk mund të gjejë që i akuzuari është fajtor pa asnjë dyshim të arsyeshëm për krime lufte kundër popullsisë civile në fshatin Nogavac.

#### b. Celine

**26 Mars 1999.** Përsa u përket veprimtarive që ndodhën më 26 Mars 1999, N [REDACTED] R [REDACTED] dëshmoi në shqyrtim se në agimin e asaj ditë, Znj. R [REDACTED] dhe familja e saj ishin fshehur në bodrum dhe u urdhëruan nga forcat serbe të dilnin jashtë. Trembëdhjetë burra, përfshirë djalin e saj 13 vjeçar, u ndanë nga gratë dhe u dërguan në oborr. Gratë u urdhëruan të largohen. Kur Znj. R [REDACTED] po largohej, ajo pa dy a tre policë të godasin burrat dhe pastaj dëgjoi të shtëna armësh në breshëri. Njëri nga burrat që mbijetoi në masakër ishte N [REDACTED] R [REDACTED] Znj. R [REDACTED] dha një dëshmi shumë të ngatërruar për uniformat e forcave serbe, derisa në fund pohoi se ata kishin veshur të gjithë uniforma maskimi.

Z. D [REDACTED] dëshmoi gjatë për ngjarjet që çuan në grabitjet e datës 28 Mars, por siç doli ai nuk kishte parë asnjërin prej masakrave. Ai vetëm kishte dëgjuar fjalë për këto masakra. Në shqyrtim, Z. D [REDACTED] u ballafaqua me faktin se në dëshmitë e mëparshme të tij më 1 Nëntor 1999 në KFOR dhe më 23 Maj 2000 në policinë e UNMIK-ut, ai nuk kishte përmendur asnjërin nga ngjarjet që kishin ndodhur deri më 28 Mars. Ai mohoi me forcë saktësinë e këtyre raporteve dhe deklaroi se i kishte përmendur të gjitha ngjarjet që kishin ndodhur midis 25 Marsit dhe 28 Marsit 1999. Mospërputhje të tilla përsëri e venë në pikëpyetje saktësinë e këtyre deklaratave.

Edhe N [REDACTED] R [REDACTED] u thirr për të dëshmuar në lidhje me masakrën e datës 26 Mars në Celine, por si përfundim ai dha një dëshmi shumë të ngatërruar për aktet e një personi të quajtur Sasa në Mala Krusa dhe nuk foli asnjëherë për ndonjë masakër në Celine.

**28 Marsi 1999.** Në lidhje me grabitjet që ndodhën më 28 Mars, Znj. R [REDACTED] dëshmoi në shqyrtim se shumë nga fshatarët ishin grumbulluar në malet pranë Celines dhe ishin rrethuar dhe ishin dërguar në një fushë të vogël ku i kishin ndarë burrat nga gratë dhe forcat serbe u kishin marrë të hollat. Burrat ishin urdhëruar të shtriheshin në tokë ndërsa gratë ishin urdhëruar të largoheshin. Ajo vazhdoi të dëshmonte për udhëtimin me forcë të tyre drejt kufirit dhe gjatë kësaj kohe asaj dhe fshatarëve të tjerë u kishin grabitur të gjitha paratë dhe sendet e çmuara, si

dhe dokumentat e identifikimit. Gjithsej, forcat Serbe i kishin vjedhur zonjës Rexhepi mbi 2000 DM.

**R** **D** dëshmoi në shqyrtim se në një moment forcat Serbe i kishin ndarë burrat nga gratë dhe u kishin marrë të gjitha paratë. Ai nuk dha ndonjë dëshmi shtesë në lidhje me këtë pretendim.

Megjithë faktin se disa nga dëshmitë lidhur me ngjarjet që ndodhën në Celine janë të ngatërruara, asnjëra prej palëve nuk e kundërshtoi ndodhinë e këtyre ngjarjeve Pyetja që mbetet është nëse i akuzuari është identifikuar drejt ose nëse ky identifikim është i besueshëm dhe kjo Gjykatë ka dyshime serioze për saktësinë dhe besueshmërinë e procesit të identifikimit.

### c. Identifikimi i të akuzuarit

Në shqyrtim zonjës **R** iu dha mundësia të rishikonte dosjet e CCIU-t. Znj. **R** dëshmoi se asaj i ishin treguar më parë foto nga KFOR në dy deri në tre raste dhe llogariti se asaj i ishin treguar rreth 30 deri në 50 foto. Ajo kujton të ketë parë disa nga fotot të paktën një herë. Në fakt, më 19 Maj 2000, dëshmitarja konfirmoi se kishte dhënë një dëshmi në policinë e UNMIK-ut por ajo nuk e kishte identifikuar Sasa Grkovicin. Gjykata mundi të konfirmojë nga dëshmia e saj se UNMIK-u i kishte treguar vërtet asaj dosjet e CCIU-t që ishin përsëri para saj në Gjykatë. Ndërsa identifikoi disa persona të tjerë si të pranishëm më 26 ose më 28 Mars, ajo ishte krejt e paaftë të replikonte me harmoni ato që i kishte deklaruar policisë së UNMIK-ut për personat që kishte identifikuar më parë.

Në shqyrtim ajo e identifikoi gjithashtu të akuzuarin nga dosjet e CCIU-t si pjesëmarrës në masakrën e datës 26 Mars. Në mënyrë të veçantë ajo deklaroi se mendonte se ai kishte marrë pjesë në ekzekutimin në oborr, kishte mbuluar kufomat me bar, u kishte hedhur lëndë djegëse dhe u kishte vënë zjarrin. I vetmi problem me këtë identifikim është se ai bie kryekëput ndesh me dëshminë e saj se ajo nuk kishte qenë atje kur burrat ishin pushkatuar në oborr. Më vonë ajo pranoi se nuk e kishte parë masakrën me sytë e vet por për të i kishin treguar më pas, kur kishte shkuar në male. **N** **R** dhe bashkëshorti i saj. Siç diskutohet më poshtë, **N** **R** nuk qe fare në gjendje ta identifikonte Sasa Grkovicin.

Për më tepër, në dëshminë e saj në shqyrtimin e parë, ajo nuk kishte deklaruar asnjëherë se i akuzuari ishte në radhët e forcave Serbe, që kishte marrë pjesë në grabitjet e datës 28 Mars 1999. Në kundërshtim me këtë dëshmi, më 25 Shtator 1999, Znj. **R** i kishte dhënë një dëshmi KFOR-it dhe kishte identifikuar Sasa Grkovicin si njëri prej policëve serbë që kishte grabitur atë dhe fshatarët më 28 Mars. Kur u ballafaqua me këtë mospërputhje, Znj. **R** nuk dha asnjë shpjegim përveç se tha që nuk i dinte emrat e tyre dhe vetëm kishte parë fotot. Për fat të keq, kjo nuk e shpjegon mospërputhjen. Në këtë rrethanë, Gjykata mund të supozojë se raporti i KFOR-it është përsëri i pasaktë sepse nuk përfshin foto të atyre personave të identifikuar nga Znj. **R** ose që dëshmitarja është thjesht konfuzë. Në secilin rast, kjo mospërputhje sugjeron me forcë mungesën e një procesi të besueshëm identifikimi.

Dëshmitarja mori pjesë edhe në rreshtimin e njerëzve në Kamp Phoenix më 20 Gusht 2001. Para se të këqyrte rreshtimin, asaj iu kërkua të jepte një përshkrim të hollësishëm të të dyshimit dhe siç kujtoi në shqyrtim, ajo e përshkroi atë si të gjatë, me sy të futur, me fytyrë të mprehtë dhe me flokë të zinj. Në mënyrë domethënëse, ajo deklaroi në marrjen në pyetje në rreshtim se, “policia më tregoi shumë foto dhe unë identifikova njërin si i dyshimti. Sot kam ndërmend të identifikoj të njëjtin person.” Në rreshtim ajo identifikoi të akuzuarin. Siç nënvizoi më parë Gjykata, për një sërë arsyes ajo ka shqetësime serioze lidhur me drejtësinë e rreshtimit.

Më e rëndësishme në këtë drejtim është se duket që dëshmitares i ishin treguar foto të paktën në dy apo tre raste të veçanta dhe rezultatet e këtyre renditjeve të fotove ose nuk janë në shkresat e Gjykatës ose nuk janë raportuar siç duhet me kopjet e fotove që i janë treguar dëshmitares bashkangjitur raportit. Në rrethana të tilla, ka të ngjarë që procesi i identifikimit të mos ketë qenë i sigurtë që në fillim dhe që dëshmitarja, duke besuar se kishte identifikuar të dyshimtin e duhur, vazhdoi ta identifikonte personin në foto më tepër si i dyshimti i duhur sesa si personi që ajo kishte parë më 28 Mars 1999 që kishte kryer grabitjet. Krahas kësaj, në marrjen në pyetje nuk ekziston absolutisht asgjë që të tregojë me saktësi se për çfarë vepre ajo e identifikoi Sasa Grkovic si autor; në mënyrë të veçantë, nëse ai mori pjesë në grabitjet apo në masakrën në oborr. Shkurt, në këto rrethana, kësaj Gjykate nuk i duket se identifikimi i të akuzuarit nga Znj. R. [REDACTED] në rreshtimin e njerëzve është provë e besueshme për të mbështetur supozimet e pretendimit kundër të akuzuarit për grabitjet e fshatarëve të Celines.

Dëshmia e Z. D. [REDACTED] në shqyrtim që identifikoi të akuzuarin është në mënyrë të ngjashme e dyshimtë. Në një moment gjatë dëshmisë së tij ai deklaroi se nuk i kujtohej nëse i akuzuari ishte njëri prej forcave serbe në fshat. Më pas ai deklaroi se e kishte parë të akuzuarin në ditën e parë në pjesën e sipërme të fshatit dhe se ai fyente, rrihte dhe grabiste njerëzit. Megjithatë, deklarata tjetër e tij para Gjykatës ishte se e kishte të pamundur të shihte sepse ia kishin lidhur duart prapa qafës. Përsëri Z. D. [REDACTED] ritheksoi se, megjithëse beson se i akuzuari kishte bërë të gjitha gjërat që kishin bërë njerëzit e tjerë, ai nuk e pa atë sepse nuk u gjend asnjëherë aq afër. Në fakt, dëshmia e Z. D. [REDACTED] është e mbushur me akuza, të ndjekura nga deklarime se ai nuk arriti në të vërtetë të ndodhej aq afër sa ta shihte të akuzuarin duke bërë ndonjë gjë, gjë që bën të qartë për këtë Gjykatë se Z. D. [REDACTED] vërtet nuk pati rast të mirë të shihte forcat serbe përgjegjëse për grabitjet dhe masakrën në oborr.

Edhe Z. D. [REDACTED] mori pjesë në rreshtimin e njerëzve më 20 Gusht 2001. Në rreshtim gjyqtari e pyeti nëse mund ta identifikonte të dyshimtin dhe ai tha po. Z. D. [REDACTED] nuk kujton nëse u udhëzua që i dyshimti mund të mos ndodhet në rreshtim. Në fund, Z. D. [REDACTED] e identifikoi të akuzuarin si “personi që mori pjesë në vrasjet që ndodhën në Celine”. Për të njëjtat arsye të nënvizuara më lart në lidhje me Znj. R. [REDACTED] saktësia dhe drejtësia e rreshtimit të njerëzve është e dyshimtë. Së pari, Z. D. [REDACTED] iu treguan foto në disa raste, siç pasqyrohet në shkresat e lëndës. Vetëm shënimet e KFOR-it tregojnë se ata i treguan renditje fotosh Z. D. [REDACTED] në tre raste të veçanta dhe policia e UNMIK-ut e përsëriti procesin të paktën një herë. Përsëri, hetimet e KFOR-it nuk pasqyrohen në asnjë raport, vetëm në shënime të pakta. Asgjë nuk tregohet se çfarë fotosh iu treguan dëshmitarit, çfarë udhëzimesh iu dhanë dhe nuk jepet asnjë foto. Në këto kushte, ka tepër të ngjarë që dëshmitari vetëm sa identifikoi në rreshtim personin që kishte identifikuar më parë në fotot. Për më tepër, ka të ngjarë që pa një udhëzim që i dyshimti mund të mos jetë në rreshtim, Z. D. [REDACTED] të ketë zgjedhur thjesht të dyshimtin më të mundshëm. Së fundi, kjo dëshmi nuk tregon as që i akuzuari po identifikohet për grabitje të supozuara. Për këto arsye, Gjykata gjen se rreshtimi i njerëzve nuk e mbështet pretendimin për grabitje të supozuara kundër të akuzuarit.

Gjykata do të nënvizonte që pësjtjellimi rreth identifikimit të të akuzuarit për grabitjet e supozuara vetëm shtohet kur vlerësohet fakti se shënimet e KFOR-it në dosje nga 1 Nëntori 1999 tregojnë se Z. D. [REDACTED] e identifikoi të akuzuarin si njëri prej serbëve të pranishëm në fshatin Celine më 28 Mars kur fshatarët ishin rrethuar, bastisur dhe u kishin grabitur paratë. Në dallim, raporti i UNMIK-ut, datë 23 Maj 2000, tregon se, megjithëse Z. D. [REDACTED] i ishte treguar dosja e fotove të CCIU-t, që përmbante foto të të akuzuarit, ai nuk e identifikoi asnjëherë të akuzuarin si person të përfshirë në ngjarjet e datës 28 Mars apo edhe ato më herët.

Në gjyq dëshmoi edhe N. [REDACTED] R. [REDACTED] Megjithëse u thirr për të dëshmuar në lidhje me masakrën në oborr, ai nuk i përmendi asnjëherë ngjarjet e 26 Marsit në Celine. Gjykata i kërkoi Z. R. [REDACTED] të shihte nëpër dosjet e CCIU-t për të identifikuar personat që morën pjesë në

masakrën në oborr. Z. R. [REDACTED] nuk identifikoi asnjë person. Kur iu kërkua të shihte në sallën e gjyqit për të parë nëse mund të identifikonte ndonjë njeri që mund të kishte marrë pjesë në masakër, ai tregoi njërin prej dëshmitarëve të alibisë së të akuzuarit, Z. V. [REDACTED] Z. V. [REDACTED] ishte i vetmi person me origjinë serbe në sallën e gjyqit, krahas të akuzuarit i cili në këtë kohë kishte veshur xhakëtë të policisë rumune të UNMIK-ut. Ky incident nënkupton për Gjykatën se ky dëshmitar thjesht kërkoi ata persona që dukej sikur ishin me origjinë serbe, dhe ngre një shqetësim serioz që ky incident nuk është i vetmi, por në mënyrë të ngjashme i vërtetë edhe për identifikimet e tjera.

Duke patur parasysh identifikimet tepër kontradiktore të bëra nga këta dëshmitarë dhe procesin qenësisht të pasigurtë të identifikimit, të përvijuar gjerë e gjatë më lart, Gjykata nuk mund të gjejë se i akuzuari është fajtor përtej çdo dyshimi të arsyeshëm për Krime Luftë kundër Popullsisë Civile, për grabitjet e pretenduara më 28 Mars 1999, ose masakrën në oborr më 26 Mars 1999.

## 7. Dëshmitarët e “Alibisë”

Nisur nga mungesa e provave para kësaj Gjykate për ndjekjen e të akuzuarit, kjo Gjykatë ka nevojë të mbështetet shumë në dëshminë e dëshmitarëve të alibisë. Megjithatë, Gjykata do të vinte në dukje se për të dëshmuar u thirrën edhe disa dëshmitarë të alibisë dhe Gjykata përfiton nga rasti të trajtojë disa momente.

Së pari, Gjykata do të dëshironte të bënte të qartë se ajo u përball me dëshminë e disa dëshmitarëve që pretenduan me forcë se dinin ku ndodhej i akuzuari në orë dhe data të caktuara. Kjo Gjykatë i konsideron dëshmi të tilla me skepticizëm.

Së dyti, Gjykatës iu paraqitën edhe dëshmi në lidhje me Sasa Grkovicë të tjerë në atë zonë. Megjithatë, Gjykata e vlerëson të panevojshme të shqyrtojë përputhshmërinë ose besueshmërinë e këtyre dëshmimeve pasi nuk u paraqitën prova të sigurta që ta identifikonin në mënyrë pozitive të akuzuarin si person që kishte qenë përfshirë në krimet e luftës të vëna në barrë midis 25 Marsit 1999 dhe 28 Marsit 1999.

Së treti, identifikimi i uniformave të veshura nga serbët nuk përputhet me dëshminë e provave të akuzës. Dëshmitarët e alibisë dëshmuar në mënyrë të njëjtë se atyre u ishin dhënë uniforma njëngjyreshe, uniforma SMB gri në ngjyrë ulliri dhe vetëm disa komandantëve u ishin dhënë uniforma maskimi ngjyrë blu. Shumë konfirmuan se edhe të akuzuarit i ishte dhënë uniformë SMB ngjyrë gri në ulliri. Përkundrazi, shumica e dëshmitarëve dëshmuar në mënyrë të paqartë për uniformat e veshura dhe në të shumtën e rasteve treguan një uniformë të llojit të maskimit por me modele dhe ngjyra të ndryshme. Prokurori publik ndërkombëtar i referohet dëshmisë së dhënë nga A. [REDACTED] M. [REDACTED] i cili dëshmoi para gjyqtarit ndërkombëtar se e njëjti të akuzuarin dhe se gjatë luftës i akuzuari mbante veshur uniformë maskimi. Dëshmia e Z. M. [REDACTED] u lexua si provë. Prokurori publik ndërkombëtar e vlerëson këtë dëshmi si vërtetuese të dëshmisë së dëshmitarëve të akuzës.

Gjykata njeh pësjtjellimin e madh lidhur me llojet e uniformave të veshura nga forcat serbe dhe që dëshmitë demonstuan se gjatë luftës janë veshur lloje të ndryshme uniformash. Kësisoj, me qëllim që të përpiqej të përcaktonte dëshminë më të saktë lidhur me uniformat, kjo Gjykatë paraqiti një dosje me fotot e uniformave të ndryshme ndër të cilat të zgjidhnin dëshmitarët. Prapëseprapë, dëshmia në lidhje me këtë ishte shumë e ngatërruar. Prandaj, kjo Gjykatë e sheh me skepticizëm çdo deklaram pa pyetje të mëtejshme mbi paraqitjet fotografike, gjë që nuk u bë nga gjyqtari hetues në rastin e A. [REDACTED] M. [REDACTED]

Pavarësisht nga mospërputhjet lidhur me uniformat, në përcaktimin e saj në lidhje me besueshmërinë e procesit të identifikimit, kjo Gjykatë vendosi të mos merrte parasysh mospërputhjet e dëshmimeve në lidhje me uniformat. Për shkak të pëshpjellimit në këtë drejtin, Gjykata e vlerësoi të nevojshme t'u jepte dëshmitarëve të akuzës të drejtën e dyshimit në lidhje me ngjyrat dhe modelet e uniformave. Megjithatë, Gjykata arrin në përfundimin e njëjtë se ajo nuk mund ta gjejë të akuzuarin fajtor, pa asnjë dyshim të arsyeshëm, për krimet e luftës që i vihen në barrë.

#### **D. Elementi katër: A i shkelin aktet rregullat e së drejtës ndërkombëtare?**

Duke patur parasysh gjetjet e kësaj Gjykate, veçanërisht duke gjetur dëshmi dhe prova të pamjaftueshme që do të vërtetonin se i akuzuari mori pjesë ose edhe që ai ishte i pranishëm gjatë krimeve të luftës kundër popullsisë civile, siç u diskutua më lart, nuk është e nevojshme të trajtohet nëse krimet e supozuara shkelën rregullat e së drejtës ndërkombëtare.

#### **IV. PARABURGIMI**

Meqë i akuzuari u lirua nga akuzat, paraburgimi i tij duhej të pezullohej sipas Nenit 353, paragrafi 3, të LPP-së.

#### **V. SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE**

Në bazë të Nenit 99, paragrafi 1, lidhur me Nenin 95, paragrafi 2, pikat 1-5, të LPP-së, shpenzimet e procedurës penale, përfshirë shpenzimet e nevojshme dhe shpërblimin e avokatit mbrojtës, duhet të paguhet nga buxheti i Gjykatës.

#### **VI. ZHDËMTIMI I PALËVE TË DËMTUARA**

Në bazë të Nenit 108(3) të LPP-së, të gjitha palët e dëmtuara udhëzohen të ngrejne padi civile për të ngritur pretendimet e tyre pasurore kundër të akuzuarit.

### **KËSHILLË LIGJORE**



Në bazë të Nenit 359 të LPP-së, kundër këtij aktgjykimi mund të depozitohet një ankim brenda 15 ditëve nga data e marrjes së një kopjeje të aktgjykimit.

Aktgjykimi origjinal u përgatit në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

**Gjykata e Qarkut Prizren**  
**04 Shtator 2002**  
**P. Nr. 45/2002**

Proces-mbajtëse  
Maria Lenie Velasquez

Përkthyen:  
Gazmend Isaj  
Kastriot Myftiu



Kryetar i Trupit Gjykses  
Georg Plüür